



WFD

WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

LËVIZJET SOCIALE (QYTETARE) NË SHQIPËRI

MES PERCEPTIMIT QYTETAR DHE
KAPACITETIT TË TYRE PËR TË NXITUR
NDRYSHIME



LËVIZJET SOCIALE (QYTETARE) NË SHQIPËRI

MES PERCEPTIMIT QYTETAR DHE
KAPACITETIT TË TYRE PËR TË NXITUR
NDRYSHIME

Autorë: **Center for Economic and Social Studies (CESS)**

Autorët prodhuan këtë raport për Fondacionin Westminster për Demokraci. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë ato të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ose Fondacionit Westminster për Demokraci.

Tiranë, Nëntor 2020

Ky botim paraqet një vështrim historik të lëvizjeve qytetare në Shqipëri pas viteve 1990-të, bën një përmbledhje të lëvizjeve në vende të tjera, si dhe thellohet në peizazhin aktual të lëvizjeve duke analizuar në mënyrë specifike vetëm gjashtë prej lëvizjeve aktuale. Ai kishte për qëllim të bënte një analizë të kapaciteteve, anëtarësisë dhe nivelit të veprimtarisë si dhe të vlerësonte nëse ekzistonte mundësia që ato të mobilizonin mbështetje dhe të nxisnin ndryshim në procesin e demokratizimit në Shqipëri. Një pjesë e rëndësishme e këtij raporti ishte anketimi dhe matja e perceptimit të qytetarëve për të pranuar dhe ndjekur këto lëvizje. Vlen të theksohet fakti se periudha aktuale parazgjedhore është shumë dinamike e mbushur me shumë zhvillime të tilla si lindja e lëvizjeve dhe/ose partive politike të reja apo shuarja e disa të tjerave.

Nga njëra anë, besimi publik te politika dhe strukturat politike ka pësuar bjerrje në vitet e fundit dhe, nga ana tjetër, aktivizmi i qytetarëve ka qenë i fragmentizuar, në rastin më të mirë. Sikurse shpjegohet në një studim të mëparshëm nga Westminster Foundation for Democracy (WFD), Kostoja e Politikës në Shqipëri është shumë e lartë dhe krijon një barrierë për hyrjen e lëvizjeve/partive të reja apo politikanëve të rinj në politikë, përveç pengesave të tjera që ekzistojnë. Në kushtet aktuale, është me shumë interes që të shihen dinamikat aktuale që janë në favor dhe disfavor për lindjen dhe forcimin e aktorëve të rinj qytetarë/politikë në vend.

Studimi u realizua nga Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale (CESS), një prej organizatave think tank më në zë që merret me hulumtime / studime të tilla dhe u mbështet nga (WFD). Fondacioni dëshiron të falënderojë CESS-in dhe ekipin e tij të hulumtuesve për përkushtimin e tyre në përgatitjen e këtij dokumenti.

WFD-ja është një organ publik në Mbretërinë e Bashkuar i dedikuar për të mbështetur demokracinë në botë. Në gusht të vitit 2018, WFD-ja nisi një Nismë trevjeçare Rajonale për Ballkanin Perëndimor titulluar "*Nisma për Demokraci në Ballkanin Perëndimor*". Nisma u financua nga *Fondi i Konfliktit, Stabilitetit, dhe Sigurisë i Qeverisë Britanike*.

Sokol Haxhiu

Përfaqësues i WFD në Shqipëri

TABELA E PERMBAJTJES

PARATHËNIE	5
1 HYRJE	9
2 LËVIZJET SOCIALE (QYTETARE), PËRKUFIZIMI DHE QASJET	
TEORIKE	18
2.1. LËVIZJET SOCIALE (QYTETARE): NJË HISTORI E SHKURTËR	18
2.2. TEORITË E LITERATURA MBI STUDIMIN E LËVIZJEVE SOCIALE	26
3 METODOLOGJIA	30
3.1 PËRSHKRIMI I TEKNIKAVE TË STUDIMIT	30
REZULTATET E ANKETES	33
4.1. GJETJET KRYESORE NGA ANKETA.....	33
5. PROFILE TË LËVIZJEVE AKTUALE SOCIALE (QYTETARE)	
NË SHQIPËRI	44
5.1 NISMA THURJE	45
5.2 LËVIZJA ORGANIZATA POLITIKE	47
5.3 LËVIZJA ALTERNATIVA	49
5.4 LËVIZJA EKOALBANIA	50
5.5 LËVIZJA VETËVENDOSJA – QENDRA NË SHQIPËRI.....	52
5.6 ALEANCA PËR MBROJTJEN E TEATRIT	54
6. KONKLUZIONE	56
BIBLIOGRAFIA	57
SHENIME	59

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1. SI E MERRNI INFORMACIONIN PËR KËTO LËVIZJE (MË SHUME SË NJË PËRGJIGJE)	33
FIGURA 2. A MERRNI PJESË NË AKTIVITETET E NDOJË PREJ KËTYRE LËVIZJEVE?.....	34
FIGURA 3. A BESONI SE KËTO LËVIZJE JANË TË PAVARURA NGA PARTITË KRYESORE?	36
FIGURA 4. A MENDONI SE KAUZAT QË ATO MBROJNË JANË TË RËNDËSISHME PËR KOMUNITETIN?	36
FIGURA 5. SA NDIKIM KANË NË JETËN PUBLIKE DHE PËRFSHIRJEN E QYTETARËVE NË VENDIM-MARRJE KËTO LËVIZJE?	37

LISTA E TABELAVE

TABELA 1. SHPËRNDARJA E ANKETAVE SIPAS QARQEVE	32
TABELA 2. PËRZGJEDHJA E QYTETIT KRYESOR DHE SEKONLAR NË SECILIN QARK.....	32
TABELA 3. A I NJIHNI LËVIZJET E MËPOSHTME QYTETARE? (NË %) ..	34
TABELA 4. SA JU TËRHEQIN LËVIZJET E MËPOSHTME? (NË %).....	36
TABELA 5. SI MENDONI SE DUHET TË JETË AKTIVITETI I KËTYRE LËVIZJEVE NË TË ARDHMEN? (NË %).....	40
FIGURA 6. A DËSHIRONI TË MERRNI PJESË NË NJË NGA KËTO LËVIZJE?	40
TABELA 6. A PLANIFIKONI TË VOTONI NË ZGJEDHJET E ARDHSHE?.....	41
TABELA 7. NËSE NUK DO TË VOTONI, CILAT JANË ARSYET?.....	41
TABELA 8. NËSE DO TË VOTONIT NESËR, A DO TË PREFERONIT TË VOTONIT PËR?	42
TABELA 9. NËSE DO TË PËRZGJIDHNIT, A DO TË PREFERONIT TË KISHIT SI DREJTUES TË VENDIT... ..	42

1 HYRJE

Rënia e sistemit totalitar në Shqipëri filloi përmes një lëvizje sociale të fuqishme siç ishte Lëvizja studentore e dhjetorit e vitit 1990, e cila, në bashkëpunim edhe me faktorë dhe aktorë të tjerë të shoqërisë shqiptare, u shëndrrua shpejt në një lëvizje të mirëfilltë politike që prodhoi edhe të parën parti politike opozitare në vend dhe legjitimoi kështu, pas gati 50-vjetësh, pluralizmin politik dhe sistemin e ri politiko-ekonomik të mbështetur tek demokracia liberale dhe ekonomia e tregut. Lëvizja e studentëve të dhjetorit kishte karakteristikat e një lëvizje sociale që u nxit nga një grup social me vetëdije të lartë atdhetare, siç ishte rinia studentore, dhe që përfundoi me realizimin e misionit të saj historik, nxitjen e ndryshimeve nga poshtë-lart dhe krijimin e situatave që bënë të mundur lejimin e pluralizmit politik.

Shqipëria e pas viteve 90' ka përjetuar disa 'valë të lëvizjeve sociale', që kanë qenë të lidhura me ciklet politike të qeverisjes dhe kanë prodhuar situata, faktorë dhe vendimmarrje, ku janë përfshirë çështje të keqqeverisjes të sistemeve zgjedhore, mbrojtjes së mjedisit e trashëgimisë kulturore, arsimit, të drejtave sociale etj. Rrjedhojë e këtij arsytimi, 'vala e parë e lëvizjeve sociale (qytetare)' në Shqipëri lidhet me periudhën 1990-1997, 'vala e dytë e lëvizjeve sociale' përkon me periudhën 1998-2005, 'vala e tretë e lëvizjeve sociale' ka qenë e lidhur me periudhën e viteve 2005-2013, ndërsa 'vala e katërt dhe e pestë' e lëvizjeve sociale shënohet nga periudha e viteve 2013-2107 dhe 2017-2020.

Fillimvitet '90, krijimi i partive të reja politike dhe pjesëmarrja e tyre në qeverisjen e vendit si dhe formimi i sindikatave të para, të krijuara sipas grupeve të interes të punonjësve në mbarë vendin, zëvendësuan pothuajse plotësisht Lëvizjen studentore. Tashmë, për disa vite, partitë politike dhe sindikatat u bënë qendrat e vetme ku mishëroheshin lëvizjet sociale për të sjellë ndryshime të dëshiruara për kauza a objektiva të caktuar.

Gjatë dekadës së parë të tranzicionit shqiptar nga totalitarizmi në demokraci, në mesin e viteve '90, pas krizës së thellë politike dhe institucionale që prodhoi mosnjohja e zgjedhjeve të përgjithshme politike të majit të vitit '96 dhe rënia pas pak muajsh

e skemave piramidale, u shfaq një lëvizje re qytetare, Forumi për Demokraci, e cila ishte e përqëndruar tek veprimtaria aktive e disa figurave publike që e shihnin fuqizimin e demokratizimit përmes zhvillimit të zgjedhjeve të lira, si faktor kryesor që do të bënte të mundur shtensionimin social. Nga ana tjetër disa lëvizje të shkëputura studentore gjatë vitit 1998 ishin disa elementë të tjerë që u përpoqën të ringjallnin sërish frymën e lëvizjeve sociale (qytetare).

Frymën e angazhimit social dhe qytetar, jashtë sistemit të partive politike, gjatë viteve 2000-2005, për çështje të tilla si mirëqeverisja dhe çështje mjedisore, u nxitën e u promovuan nga disa lëvizje të reja qytetare ku spikatën Koalicioni qytetar kundër korrupsionit, Lëvizja Mjaft dhe Aleanca për mbrojtjen e Gjirit të Vlorës. Nga këto lëvizje, tërhoqi vëmendjen e publikut Lëvizja Mjaft, e cila, përmes metodave inovative të mobilizimit qytetar nxiti në atë periudhë angazhimin qytetar përmes formave e mjeteve jotradicionale të protestës. Një pjesë e drejtuesve të Lëvizjes Mjaft, pas një aktiviteti katër vjeçar (2004-2008), u shkëputën nga kjo lëvizje dhe në vitin 2008 krijuan partinë politike Grupimi 99 (G99) që mori pjesë në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 28 Qershorit të vitit 2009¹ si pjesë e koalicionit të majtë Bashkimi për Ndryshim, ku mori 12,989 vota ose 0.86% të votave në nivel kombëtar. Ndërkohë ajo mori pjesë sërish në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 23 qershorit të vitit 2013² në kuadër të koalicionit të majtë Aleanca për Shqipërinë Europiane, ku në nivel kombëtar mori 2,977 vota ose 0.17%. Ndërsa në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit 2017, ku çdo parti u paraqit në zgjedhje si subjekt elektroral më vete, G99 nuk u regjistrua për të marrë pjesë në këto zgjedhje. Në këtë periudhë u shfaqën edhe dy lëvizje të reja politike, siç ishin partia Lista e Barabartë apo partia LIBRA e drejtuar nga ish-deputeti i PS Ben Blushi, e cila në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 25 qershorit 2017 mori në nivel kombëtar 19,806 vota ose 1.25 % ndërsa lëvizja Sfida për Shqipërinë e drejtuar nga një grup intelektualësh të rinj si Gjergj Bojaxhiu, Ermal Hasimja etj., mori 3,546 vota apo 0.22%.

Gjithashtu, gjatë periudhës 2004-2007, spikati lëvizja qytetare Aleanca për Mbrojtjen e Zhvillimin të Gjirit të Vlorës, krijuar në vitin 2004 si reagim qytetar, pasi qeveria shqiptare i dha një koncesion shumë të debatuar Kompanisë Petrolifera për ndërtimin e

1 http://cec.org.al/images/stories/zgjedhje-per-kuvend/2009/rez_zaz.pdf

2 <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/06/permbledhese-2013.pdf>

rezervuarëve të naftës pranë Portit të Vlorës.³ Kundërshtimi i këtij vendimi nga lëvizja Aleanca për Mbrojtjen e Zhvillimin e Gjirit të Vlorës lidhet me faktin se ai është një gji i mbyllur, ku një ndotje e mundshme nga nafta mund të kërkonte vite dhe dekada që të largohej për shkak të nivelit të ulët të qarkullimit të ujit të detit nga gjiri për në det të hapur. Njëkohësisht, aty parashikohej të ndërtohej një park i madh industrial prej 560 hektarësh, ngjitur me rërën e plazhit dhe pyllin e Pishë Poros, që është afër me portin e vjetër dhe Lagunën e Nartës, të cilat ishin parashikuar si Zonë e Mbrojtur nga Konventa e Ramsarit për Lagunat.

Në vijim të këtij reagimi, Aleanca për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Gjirit të Vlorës, përgjatë viteve 2004-2007, zhvilloi një fushatë të gjerë ndërjegjësimi në opinionin publik me protesta dhe debate publike në median e shkruar e elektronike dhe arriti të mbledhë 14 mijë firma për organizimin e një referendumi lokal. Falë këtij aktiviteti, ajo mori tiparet e një lëvizje të gjerë sociale, duke qenë nën drejtimin e aktivistëve mjedisorë si prof. Sazan Guri e Lavdosh Feruni. Më 27 prill 2005, aleanca iu drejtua me një kërkesë autoriteteve të Konventës së Aarhusit (AAC) të nënshkruar nga qeveria shqiptare dhe që parashikonte konsultimin publik për projekte me rëndësi për mjedisin. Kërkesa e tyre për të zhvilluar një referendum u hodh poshtë më 25 nëntor 2005 nga KQZ dhe pavarësisht se vendimi u apeluua në Gjykatë, Gjykata e Lartë e refuzoi këtë kërkesë në dhjetor 2006. Megjithë reagimin e vazhdueshëm publik nëpërmjet protestave dhe pjesëmarrjen e gjerë në debatet publike e mediatike, më 9 shkurt 2007, KESH-i firmosi një kontratë 92 milion EURO me Italy's Maire Engineering SpA, për të ndërtuar TEC-in e Vlorës, duke injoruar konkluzionin e AAC dhe përpjekjet e Aleancës për më shumë se 2 vjet e gjysëm.

Nga ana tjetër gjatë periudhës së viteve 2011-2013 Shqipëria përjetoi një lëvizje tjetër siç ishte Aleanca Kuq e Zi që kundërshtoi fillimisht procesin e regjistrimit të popullsisë shqiptare në bazë të vetëdeklarimit të etnisë dhe më pas politikat e shtetit shqiptar në raport me Greqinë. Ndërkohë lëvizja Aleanca Kuq e Zi (AKZ) u regjistrua si subjekt elektoral më vete gjatë zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit të vitit 2013⁴ dhe nuk iu bashkëngjiti asnjërit prej dy koalicioneve të partive kryesore që konkuruan në këto zgjedhje siç ishin koalicioni i majtë Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASHE) dhe koalicioni i djathtë Aleanca për Punësim,

3 <https://ekolevizja.wordpress.com/2007/09/16/tre-banka-mbeshtesin-qeverine-shqiptare-kunder-zhvillimit-te-qendrueshem>

4 <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/06/permbledhese-2013.pdf>

Mirëqenie e Integrim (APMI). AKZ arriti të marrë në nivel kombëtar 10,196 vota ose 0,59% dhe në bazë të këtij rezultati nuk arriti të përfaqësohet në Parlamentin shqiptar me deputetë. Ndërsa në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit 2017,⁵ ku çdo parti u paraqit në zgjedhje si subjekt elektoral më vete, lëvizja Aleanca Kuq e Zi (AKZ) nuk u regjistrua për të marrë pjesë në këto zgjedhje.

Një lëvizje e gjerë sociale (qytetare) sërisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit ishte edhe Aleanca Kundër Importit të Plehrave (AKIP), e cila u krijua në 23 tetor 2011 si një lëvizje për një çështje të rëndësishme që lidhej me mbrojtjen e mjedist dhe shëndetit të njerëzve. Qëllimi i kësaj aleance ishte ndalimi importit të plehrave në Shqipëri duke kërkuar shfuqizimin e nenit 49 të Ligjit për Menaxhimin e Mbetjeve të Integruara që ishte miratuar nga Parlamenti shqiptar në vitin 2011 me votat e mazhorancës së atëhershme dhe me kundërshtimin e fuqishëm të deputetëve të opozitës. Si rrjedhojë e mbështetjes së ish-opozitës së majtë në vitin 2011 për Aleancën Kundër Importit të Plehrave (AKIP), kur erdhi në pushtet pas zgjedhjeve të 2013, e anuloi këtë ligj në Shtator të vitit 2013. Përmes ndërgjegjësimit dhe aksionit publik, Aleanca Kundër Importit të Plehrave (AKIP) arriti të mbledhë 60,000 firma për të zhvilluar një referendum por, për shkak se ligji u anulua, referendumi nuk u zhvillua. Megjithatë, lëvizja e Aleancës Kundër Importit të Plehrave (AKIP) e rifilloi sërisht aktivitetin e saj kur Ligji i shumë diskutuar i importit të mbetjeve u risoll për miratim në Qershor 2016, nga maxhoranca socialiste. Ky ligj, ndonëse u miratua, ai nuk u dekretua nga ish-Presidenti Nishani, duke u rikthyer në parlament më 14 tetor 2016, për tu miratuar më pas, me disa ndryshime nga ana e Parlamentit shqiptar, në shtator 2017.

Në periudhën mes viteve 2014-2016 në Shqipëri u shfaqën një sërë lëvizjesh sociale që ishin të lidhura me aspektet e mbrojtjes së hapësirës urbane publike në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë. Kështu vitin 2014, aktivistët e shoqërisë civile dhe organizatatave të mjedisit zhvilluan një lëvizje për gati 1 vit për të kundërshtuar ndërtimin e 5 kullave 17 katëshe poshtë territorit të digës së liqenit artificial të Tiranës si rezultat i vendimit të KRT të Bashkisë Tiranës të datës 1 Gusht 2014.⁶ Nisma “*Qytetarët për Parkun*” vazhdoi e vetme protestat përballë Bashkisë dhe Kryeministrit nën moton “*Zero park, zero vota*”, duke synuar të ndalte projektin me vlerë 100 milionë euro, që rëndonte

⁵ <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/06/permbledhese-2017.pdf>

⁶ <https://www.reporter.al/beteja-ligjore-per-kompleksin-100-milione-euro-tek-diga-e-liqenit/>

dendësinë e ndërtimeve rreth Parkut të Liqenit. Për të realizuar synimin e tyre ata arritën edhe të kandidonin aktivistin Gjergj Bojaxhiu si kandidat të pavarur dhe pjesë e nismës *Ne Tirana*, por të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të 21 qershorit 2015, por ai nuk arriti të fitonte, duke marrë vetëm 16,303 vota. Megjithatë, kandidimi i tij si kandidat i pavarur shënoi një sukses pasi arriti të marrë numrin më të madh të votave që ishte marrë ndonjëherë nga një kandidat i vetëm kundër koalicioneve të mëdha në 25 vjet procese zgjedhore. Gjithashtu, në atë periudhë Lëvizja *ShqipOn* kërkoi mbajtjen e referendumit popullor për shfuqizimin e pjesës së Planit të Rregullimit të Territorit që parashikonte ndërtimin e 5 kullave poshtë digës së Liqenit Artificial të Tiranës.⁷ Ky peticion synonte të realizonte një referendum lokal për të anuluar pjesërisht Planin e Rregullimit të Tiranës, në hapësirën poshtë digës dhe argumentonte se ndërtimi i këtyre kullave do mundësojë më tej tharjen e liqenit të Tiranës dhe si pasojë zhdukjen e parkut të tij si e vetmja mushkëri e 1 milion qytetarëve të Tiranës. Por të gjitha këto përpjekje të këtyre lëvizjeve nuk arritën ta realizojnë qëllimin pasi, megjithëse përmes një vendimi të 14 janarit 2015, INUK e shpalli të paligjshme lejen e ndërtimit dhe urdhëroi bllokimin e punimeve, dhjetë ditë më pas, Gjykata Administrative e Tiranës e shkallës së parë, e rrëzoi bllokimin, duke i hapur dritën jeshile punimeve të kompanisë, çka më pas u konfirmua përfundimisht më 3 Prill 2018 edhe nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit.

Ndërkohë nga 20 shkurt deri në 1 qershor 2016 u zhvillua lëvizja *Mbro Parkun e Liqenit* që ishte nismë e një sërë aktivistësh të shoqërisë civile e ambientalistë, të cilët kundërshtonin vendimin e Bashkisë Tiranë për të ndërtuar një kënd lojërash për fëmijë në Parkun e Liqenit Artificial të Tiranës. Sipas këtyre aktivistëve këndi i lojërave ishte i përbërë nga shtresa betoni mbi sipërfaqen e gjelbër dhe bënte të mundur prerjen e pemëve për ti liruar vend paisjeve të këtij këndi. Përfaqësues të kësaj lëvizje vazhduan protestat për disa muaj me moton: "*Mbro Parkun e Liqenit, të mbjellim pemë në vend të betonit!*" duke krijuar përplasje me policinë bashkiake. Kauzës së tyre iu bashkuan edhe deputetët e Partisë Demokratike që përfaqësonte opozitën parlamentare dhe opozitën në Këshillin Bashkiak të Tiranës pasi në zgjedhjet lokale të vitit 2015, Partia Demokratike e kishte humbur bashkinë e Tiranës që ishte fituar nga përfaqësuesi i PS z. Erjon Veliaj. Por pavarësisht kundërshtimeve të kësaj lëvizje, Bashkia e Tiranës e

⁷ <https://www.change.org/p/qytetar%C3%ABT-referendum-p%C3%ABr-liqenin-e-tiran%C3%ABs>;
<http://levizjashqipon.org/>

realizoi projektin dhe më 1 qershor 2016 inaguroi përfundimin e ndërtimit të këndit të lojërave në Parkun e Liqenit.⁸

Ky historik i shkurtër mbi lëvizjet sociale të pas viteve 90' na dëshmon se ato janë karakterizuar nga tipologji të ndryshme, ku duket sikur kanë mbizotëruar çështje që kanë qenë të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, por në fakt ato kanë qenë rrjedhojë e perceptimit qytetar se ato vendime që çënonin mjedisin urban apo natyror lidheshin me keqqeverisjen e abuzimin me pushtetin. Nga ana tjetër, siç tregojnë të dhënat e mësipërme, lëvizjet sociale (qytetare) kur janë shndërruar në subjekte elektorale, nuk kanë arritur të përfaqësohen në parlamentin shqiptar me deputetë, çka tregon se fuqia e tyre elektorale dhe pesha e ndikimit tek votuesit është shumë e ulët, duke dëshmuar se elektorati shqiptar megjithëse është mosbesues ndaj partive kryesore, ende ruan një prirje tradicionale në sjelljen e tij elektorale. Eksperienca e Lëvizjes Mjaft dhe Aleancës Kuq e Zi ishte një dëshmi, se lëvizjet sociale, në kushtet kur raporti dhe pesha e partive politike brenda një shoqërie të caktuar është shumë e madhe, atëherë mundësia më e mirë për të garantuar ndryshimet në fusha të caktura është që të shndërrohen në subjekte elektorale për të ndikuar drejtpërdrejt në vendimarrje. Megjithatë, shumica nga këto lëvizje, pavarësisht këmbënguljes dhe kauzës që kanë mbrojtur, veçanërisht për çështje që lidhen me mbrojtjen e mjedisit apo hapësirës urbane, nuk kanë arritur të detyrojnë autoritetet shtetërore të tërhiqen nga vendimet e tyre. Një ndër shkaqet kryesore mund të konsiderohet mungesa e pjesëmarrjes aktive qytetare në këto lëvizje për të realizuar veprimtari të gjera me ndikim publik në vendimarrje, ashtu sikurse dhe mungesa e reagimit dhe 'indiferenca institucionale' nga institucionet shtetërore, ndaj këtyre lëvizjeve.

Ndërkohë Shqipëria vitet e fundit ka dëshmuar një nga eksperiencat e vetme kur lëvizjet sociale kanë mundur të tregojnë forcën e tyre dhe të ndikojnë procesin e vendimarrjes publike, përmes forcës së mobilizimit të masave dhe ndërgjegjësimit publik. Një shembull i tillë në vitet e fundit ishte lëvizja kundër shkatërrimit të armëve kimike siriane në Shqipëri, që më 15 nëntor 2013 e detyroi qeverinë shqiptare të tërhiqet nga një marrëveshje në parim me SHBA që këto armë të shkatërroheshin në Shqipëri.⁹

Gjithsesi, siç e kemi përmendur, historia e lëvizjeve sociale

⁸ <https://www.tirana.al/artikull/gati-kendi-i-lojrave-tek-liqeni>

⁹ <https://kryeministria.al/newsroom/ja-e-verteta-e-armeve-kimike/>

(qytetare) në Shqipëri pas viteve 90' është e përbërë nga shembuj të ndryshëm që kanë patur si objektiv të tyre aspekte të veçanta që lidhen me cilësinë e qeverisjes, çështjet e mjedisit, transparencën publike etj.

Ndërkohë, në Shqipëri gjatë këtyre viteve të fundit janë krijuar një sërë lëvizjesh sociale që kanë lindur për të mbrojtur çështje të caktuara. Lëvizje të tilla si Nisma Thurje, Alternativa, Organizata Politike, Lëvizja për Universitetin, Lëvizja Vetvendosje-Qendra në Shqipëri, EcoAlbania, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar, lëvizja Koalicioni për Shqipërinë,¹⁰ Lëvizja Diaspora për Shqipërinë e Lirë¹¹ apo Lëvizja e Lirë janë dëshmi se grupe të caktuara të shoqërisë shqiptare kërkojnë një nivel tjetër përfaqësimi përtej sistemit të partive politike për të mbrojtur çështje me rëndësi për interesin publik. Niveli i ndikimit të tyre në shoqërinë shqiptare dhe në institucione është i ndryshëm dhe shpesh i ndërvarur nga kapaciteti i tyre financiar e organizativ, për të mobilizuar masat në përkrahje të çështjeve që ato mbrojnë. Nga ana tjetër, potenciali i tyre për t'u shndërruar në aktorë politikë, parti politike, që ndikojnë dhe marrin pjesë drejtpërdrejtë në proceset elektorale, është i lidhur me peshën dhe rolin e tyre përballë perceptimit qytetar.

10 Lëvizja drejtohet nga avokati dhe aktivisti Altin Goxhaj. Në statusin e saj kjo lëvizje është përcaktuar si 'lëvizje që i përket spektrit politik të djathtë konservator, duke qenë antiestablishment, antikomuniste, antigjarkike dhe antisoros, patriotike dhe sovraniste, proamerikane dhe euroskeptike'. Për më shumë info <https://www.pershqiperine.al> <https://www.facebook.com/KoalicioniPerShqiperine/>; <https://twitter.com/PerShqiperine>

11 Lëvizja Diaspora Për Shqipërinë e Lirë lindi nga dy përfaqësues të diasporës shqiptare, Florian Haçkaj (Zvicër) dhe Bledar Millaqi (Gjermani), të cilët u përfshinë në Aleancën për Mbrojtjen e Teatrit dhe pas shëmbjes së godinës së Teatrit Kombëtar më 17 Maj 2020 u nxitën të krijonin një lëvizje të tillë. Nëpërmjet kësaj lëvizje synimi i tyre parësor është garantimi i të drejtës së votimit në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale nëpërmjet postës, të shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë Shqipërisë, si një detyrim ligjor i shtetit shqiptar i papërbushur kundrejt shtetasve të tij. Nëpërmjet letrës që ata i dërguan Presidentit të Republikës, Kuvendit të Shqipërisë, kryetarëve të forcave politike, Ministrat të Shtetit për Diasporën dhe Përfaqësive Diplomate, argumentuan se fakti që sipas INSTAT numri i diasporës së re llogaritet të jetë rreth 1,64 milionë shtetas jashtë vendit ose rreth 36% të shtetasve shqiptarë është e domosdoshme që atyre tu garantohet votim elektronik me anë të postës apo edhe pranë ambasadave të tyre, në shtetet ku ata banojnë. Për më shumë info <https://www.diasporaofalbania.com/>

2. LËVIZJET SOCIALE (QYTETARE), PËRKUFIZIMI DHE QASJET TEORIKE

2.1. LËVIZJET SOCIALE (QYTETARE): NJË HISTORI E SHKURTËR

Lëvizjet sociale (*qytetare*) janë një fenomen i njohur që kanë lindur në shumë vende të Europës Perëndimore e Lindore, të cilat ngrihen në mbrojtje të kauzave a çështjeve të caktuara. Në përgjithësi, këto lëvizje, si përpjekje e organizuar e një grupi njerëzish për të arritur qëllime të caktuara sociale apo politike, kanë lindur si nevojë legale për të kundërshtuar akte qeveritare që dëmtojnë interesa të gjera publike. Lëvizjet sociale apo qytetare janë një rast tipik i ndryshimeve nga poshtë-lart brenda shoqërive dhe sistemeve të ndryshme politike.

Studiuesit e shkencave politike e të sociologjisë kanë përcaktuar përkufizime të ndryshme në lidhje me këto lëvizje, të cilat varen nga faktorë të ndryshëm. Në vende të ndryshme, të paktën që prej gjysmës së dytë të shek. XIX, janë formuluar një sërë teorish të ndryshme që përpiqen të shpjegojnë shkaqet, faktorët, peshën dhe rolin që ato luajnë për të nxitur ndryshime të caktuar në nivel social apo politik brenda shoqërive ku ato lindin. Përgjatë dy dekadave të shek. XXI, roli e pesha e tyre është fuqizuar për shkak të ndikimit të teknologjive të informacionit dhe mjeteve të komunikimit, mediave sociale si interneti, Facebook –u, etj. Një rast i tillë tipik janë lëvizjet e protestës qytetare në Lindjen e Mesme gjatë viteve 2010-2011, veçanërisht lëvizja Jasemin në Tunisi dhe e Sheshit Tahrir në Egjipt, që u masvizuan dhe arritën sukses për shkak të rolit të internetit.¹²

Lëvizjet qytetare apo sociale kanë në qendër të veprimtarisë së tyre angazhimin dhe veprimin social në formën e grupeve ku përfshihen individë, organizata apo të dyja bashkë. Studime të shumta kanë dëshmuar lidhjen që ekziston në raste të veçanta mes lëvizjeve qytetare dhe potencialit të tyre demokratik për t'u shndërruar në parti të reja politike. Larmia dhe tipologjia e këtyre lëvizjeve është e ndryshme dhe një sërë sociologësh i klasifikojnë ato duke shqyrtuar elementë të tillë si qëllimi, lloji i ndryshimit që

12 Dolata, Ulrich; Schrape, Jan-Felix (2016). "Masses, Crowds, Communities, Movements: Collective Action in the Internet Age". *Social Movement Studies*. 15 (1): 1–18

sjellin, metodat që përdorin, shtrirja në territor dhe kohëzgjatja e tyre. Disa studiues pohojnë se veçanërisht lëvizjet sociale në vendet perëndimore u bënë të mundura falë përhapjes së gjerë të arsimit, vetëdijes sociale dhe rritjes së lëvizjes së fuqisë punëtore, si rrjedhojë e industrializimit e urbanizimit të shoqërive të shek. XIX.¹³ Liria e shprehjes, arsimit dhe pavarësia relative ekonomike që janë mbizotëruese në kulturën moderne të vendeve të Perëndimit, janë faktorë nxitës për një numër të lartë lëvizjesh sociale bashkëkohore me qëllime të ndryshme.

Natyrisht, lëvizjet sociale kanë fazat e tyre të zhvillimit historik në Europën Perëndimore e Lindore e rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjatë periudhës së viteve 1945-1990 në Europën Perëndimore këto lëvizje e arritën kulmin e tyre gjatë mesit të vitet 60' me lëvizjet studentore në Francë e Itali, si rrjedhojë e së ashtuquajturës 'E Majta e Re' (*New Left*). Ndërkohë, një pjesë e rëndësishme e tyre janë të ashtuquajturat lëvizjet e reja sociale (*New Social Movements*) me të cilën janë përkufizuar ato që lindën në fund të viteve 60' të shek. XX dhe përfshinin lëvizjet që lidheshin me çështjet e mjedisit, çarmatimit, të komuniteteve LGT, të drejtave të grave etj. Lëvizjet sociale anti-bërthamore dhe mjedisore ishin ato që shënuan në mënyrë të veçantë vendet e Europës Perëndimore deri në përfundimin e Luftës së Ftohtë. Shumë grupe të lëvizjeve anti-bërthamore arritën të krijojnë struktura të tilla si Fushata kundër Çarmatimit Bërthamor (*Campaign for Nuclear Disarmament*), Miqtë e Tokës (*Friends of Earth*), Paqja e Gjelbër (*Greenpeace*), Fizikantët Ndërkombëtarë për Parandalimin e Luftës Bërthamore (*International Physicians for the Prevention of Nuclear War*), Veprimi për Paqe (*Peace Action*) apo Shërbimi i Burimeve për Informacionin Bërthamor. Këto lëvizje lindën dhe u zhvilluan në të gjitha vendet e Europës Perëndimore ku objektivi fillestar i lëvizjes ishte çarmatimi bërthamor, që përfshinte edhe kundërshtimin e përdorimit të energjisë bërthamore.¹⁴ Si rezultat i lindjes së këtyre lëvizjeve masive, që kishin në themel vetëdijen kolektive për paqe dhe ruajtjen e mjedisit, u krijuan Partitë e Gjelbra në vitet 70-80 të shek. XX, të cilat morën një rol të rëndësishëm veçanërisht në skenën politike të vendeve të Europës Veriperëndimore si Gjermania, Suedia, Danimarka, Holanda etj. Ndërgjegjësimi i publikut u rrit në mënyrë të ndjeshme pas testeve bërthamore në Oqeanin Paqësor dhe rritja e nivelit të protestës së publikut

13 Scott, John; Marshall, Gordon (2009), "Social movements", A Dictionary of Sociology, Oxford University Press, ISBN 978-0-19-953300-8

14 Kitschelt, H. (1986) Political Opportunity Structures and Political Protest: Anti-Nuclear Movements in Four Democracies. *British Journal of Political Science*, 16(19): 57–85. DOI: <http://dx.doi.org/10.1017/S000712340000380X>

në shumë vende të Europës Perëndimore solli nënshkrimin e Traktatit të Ratifikimit të Pjeshtëm të Provave Bërthamore (*Partial Test Ban Treaty*) në 5 gusht 1963 në Moskë nga ana e SHBA, BS, Mbretërisë së Bashkuar që u pasua me nënshkrimin e 123 vendeve të tjera. Përveç kundërshtimit të armatimit bërthamor, këto lëvizje sociale kundërshtuan fuqimisht edhe përdorimin e energjisë bërthamore, që e konsideronin rrezik të madh për ndotjen e mjedisit dhe shëndetin. Një shembull i tillë tipik ishte suksesi i lëvizjes për kundërshtimin e ndërtimit të termocentralit të energjisë bërthamore në Wyhl të RFGj në rajonin e Emmendingen në landin e Baden–Wurtembergut në Gjermaninë jugperëndimore, ku mijëra njerëz, nga 17-23 shkurt 1975, pushtuan në shenjë mosbindje territorin ku do të ndërtohej ky termocentral, çka bëri të mundur që më 21 shkurt 1975 gjykata administrative të anuloi licensën për ndërtimin e tij.¹⁵ Suksesi i kësaj lëvizje nxiti e frymëzoi lëvizje të tjera sociale kundër rrezikut të përdorimit të energjisë bërthamore në vende të tjera të Europës dhe Amerikës së Veriut. Ndërkohë, si rrjedhojë e aksidenteve në termocentralet e energjisë bërthamore në vende të ndryshme si SHBA, BS e Japoni dhe presionit të lëvizjeve sociale (qytetare) kundër përdorimit të kësaj energjie, është bërë e mundur që vende të tilla të zhvilluara si Australia, Austria, Danimarka, Norvegjia të mos kenë termocentrale bërthamore, kurse vende si Gjermania, Spanja, Italia, Zvicra të planifikojnë afate kur do të shképuten nga përdorimi i kësaj energjie.

Gjatë viteve 1975-1989, megjithëse Europa Perëndimore po përjetonte procesin e integritit të thelluar europian, vazhdonin të dalloheshin lëvizjet sociale që ishin kundër procesit të riarmatimit, si pjesë e zhvillimit të Luftës së Ftohtë. Në këtë kuadër ishte e ashtuquajtuara '*Java e Paqes (Peace Week)*', që filloi më 22 tetor 1983 në Gjermani, kundër vendimit të NATO-s për të instaluar raketat Pershing II në territorin e RFGJ ku 250-500,000 protestues u mblodhën në Bon për të vazhduar më pas në kryeqytete të tilla si në Romë, Londër, Amsterdam e Madrid.

Ndër lëvizjet më të fuqishme sociale në Europën Perëndimore janë ato që lidhen me mbrojtjen e çështjeve mjedisore. Mjedi si u shndërrua në një element të rëndësishëm të protestave sociale për shkak të ndikimit në cilësinë e jetës, që kishte filluar të shkaktonte industrializimi i vrullshëm që pas gjysmës së dytë të shek. XIX përmes ndotjes dhe që përkonte me fillesat e Revolucionit Industrial. Ngjarja e Smogut të Madh të Londrës

¹⁵ Wolfgang Rudig (1990). *Anti-nuclear Movements: A World Survey of Opposition to Nuclear Energy*, Longman

(*Great London Smog*) ku si pasojë e ndotjes së ajrit nga ngrohja përmes qymyrgurit, nxititi protesta dhe bëri të mundur miratimin e Aktit të Ajrit të Pastër (Clean Air Act) në 1956, falë protestave që u nxitën si shkak i saj. Ndërkohë lëvizjet sociale e qytetare për çështjet e mjedisit në Europën Perëndimore nxitën OKB që gjatë Konferencës së OKB mbi Mjedisin Njerëzor (United Nations Conference on the Human Environment) 5-16 qershor 1972, të krijonte Programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UN Environment Programme) duke e vendosur mjedisin në qendër të agjendës ndërkombëtare, që do të kulmonte në vitet e mëpasme me lëvizjet për ndryshimin e klimës (*climate change movement*). Falë këtij angazhimi të lëvizjeve sociale në fushën e mjedisit, u krijua në vitin 1998 Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimin e Klimës i OKB (*The Intergovernmental Panel on Climate Change IPCC*) me mbështetjen nga Organizata Botërore e Meteorologjisë (*World Meteorological Organization-WMO*) dhe Programi i OKB për Mjedisin (*United National Environment Programme UNEP*) që me raportet e tij për klimën nxititi nënshkrimin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës (*The United Nations Framework Convention on Climate Change - UNFCCC*) e 4 qershorit 1992 apo Samiti i Tokës (*Earth Summit*) në Rio de Janiero (Brazil) që u pasua nga organizimi i Konferencave të Shteteve Palë (*Conference of the Parties – COP*). Që nga viti 1992-2020 janë organizuar 25 konferenca të kësaj natyre të njohura me akronimin COP1, 2...deri tek konferenca e COP25 që u zhvillua në New York më 23 Shtator 2019. Që nga 16 shkurti 2005 kur hyri në fuqi Protokollit i Kiotos (i miratuar më 11 dhjetor 1997 gjatë COP3 në Kioto Japoni) Konferencat e Shteteve Palë të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës emërtohen si Takimet e Palëve të Protokollit të Kiotos (*Meeting of the Parties of the Kyoto Protocol- CPM*). Këto takimi apo Samite të Klimës (*UN Climate Summit*) duke qenë se debatojnë për ndryshimet e klimës dhe detyrimet e vendeve të zhvilluara për të reduktuar emetimet e dioksidit të karbonit në atmosferë, lëvizjet sociale për mbrojtjen e mjedisit veçanërisht në Europë apo edhe SHBA i kanë shndërruar në platforma debati e mobilizimi të publikut si lëvizjet e njohura Koalicioni për Veprimin e Energjisë (*Energy Action Coalition*), Thirrja Globale për Veprimin e Klimës (*Global Call for Climate Action*), Lëvizja e Njerëzve për Klimën (*People Climate Movement*), Mobilizimi i Klimës (*Climate Mobilization*) apo tashmë së fundi lëvizja Greva e Shkollës për Klimën (*School Strike for Climate*) e aktivistes së re mjedisore Greta Thunberg.¹⁶

16 Holdo, Markus (2018) "Sincerity as Strategy: Green Movements and the Problem of Reconciling

Ndërkohë, periudha e pas viteve 90' ishte dëshmi e lëvizjeve të tjera sociale (qytetare) në vende të ndryshme të Europës Perëndimore, Qëndrore e Lindore dhe në rajonin e Europës Juglindore, falë zhvillimeve social-ekonomike që pasuan fundin e Luftës së Ftohtë dhe rënien e regjimeve komuniste. Pas viteve 90' në vendet e Europës Perëndimore u shfaqën një sërë lëvizjesh që lidhen me anti-globalizimin dhe efektet e tij në ekonominë kombëtare të vendeve të ndryshme. Qëllimi i lëvizjeve sociale ishte kundërshtimi i efekteve të globalizimit në ekonominë kombëtare, duke kundërshtuar në mënyrë të veçantë veprimtarinë e atyre institucioneve që i konsideronin si bazë e globalizimit si Banka Botërore (BB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) dhe traktatet e tregtisë së lirë si Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut (NAFTA), Marrëveshja e Transpaqësorisë për Tregtinë (TPPA), Marrëveshja Shumëpalëshe për Investimet (MAI) dhe Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime (GATS).

Lëvizjet sociale antiglobaliste (*Antiglobal social movement*) u shënuan nga e ashtuquajtura Beteja e Siatëllit apo siç u njohën më pas si Populli i Siatëllit (*People of Seattle*) ku më 30 nëntor 1999 dhjetëra mijëra protestues u bënë pjesë e manifestimit ndaj Takimit të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) duke kundërshtuar politikën e saj përpara i përket ndikimit që kishte globalizmi tek standartet e mjedisit e të drejtat e punëtorëve. Slogani i tyre *Mendo globalisht, vepro lokalisht* (Think globally, act locally) ishte një ndër elementët kryesorë. Këto protesta të kësaj lëvizjeje energjike sociale u paraprinin takimeve të OBT apo G8, vëndeve më të industrializuara të botës. Që prej viteve 1980' kjo lëvizje ka realizuar një sërë protestash si Berlin '88, Paris '89, Madrid '94, etj., të cilat përkonin me zhvillimin e takimeve periodike të institucioneve ndërkombëtare që ata i konsideronin si nxitësit e tregtisë së lirë e globalizimit ekonomik siç janë BB, FMN, G8, OBT, duke rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi këtë fenomen ekonomik, social e politik që është bërë karakteristika kryesore e shek. XXI.¹⁷

Njëherësh, lëvizjet sociale antiglobaliste në Europën perëndimore morën formën e lëvizjeve të majta anti-globaliste dhe lëvizjeve të djathta antiglobaliste me karakter nacionalist që

Deliberative and Instrumental" Environmental Politics. 28 (4). (<https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/09644016.2018.1457294>)

17 Bosi, L. and Uba, K. (2009) Introduction: The Outcomes of Social Movements. Mobilization: An International Journal 14 (4): 409-415.

ishin njëkohësisht pjesë e sistemit të partive politike ku spikasin lëvizje të tilla si Fronti Kombëtar Francez (Francë), Partia e Lirisë (Austri), Lidhja e Veriut (Itali), Partia Nacional Demokratike – Gjermani, Partia Kombëtare e Pavarur (UK). Nga ana tjetër lëvizje të tilla si Veprimi Global i Njerëzve (*People Global Action-PGA*) dhe Antifa janë bërë simbol i kundërshtimit nga poshtë që përmbledhin një sërë lëvizjesh sociale radikale që drejtojnë fushata e veprime të drejtpërdrejta kundër neoliberalizmit.

Në këtë proces, një nga zhvillimet kryesore shënon themelimin në vitin 2001 i Forumit Social Botëror (*World Social Forum*), një iniciativë e Oded Grajew, Chico Whitaker dhe Bernard Cassen. Iniciativa e lëvizjes së Forumit Social Botëror u mbështet nga qyteti i Porto Alegre në Brazil dhe Partia e Punëtorëve të Brazilit. Lëvizja, me sloganin e saj: Është e mundur një botë tjetër (*Another World is Possible*), lindi si kundërvënie ndaj Forumit Ekonomik Botëror që zhvillohej në Davos, një kundër-reagim nga poshtë i modelit të globalizimit që mbështetej nga elitat ekonomike e politike. Përmes Këshillit Ndërkombëtar të Forumit Social Botëror (*World Social Forum*), u krijuan komitetet lokale që u shndërruan në qendra me 75,000 delegatë, që bashkonin lëvizje e organizata të ndryshme të cilat kundërshtonin kapitalizmin neoliberalist. Kjo lëvizje spikati në mënyrë të dukshme gjatë protestave për të kundërshtuar luftën në Irak. Ajo u pasua nga Forumi Social Europian (European Social Forum) – ESF që u krijua në Firence nën sloganin *Kundër luftës, kundër racizmit dhe kundër neoliberalizmit (Against the war, against racism and against neo-liberalism)* duke organizuar një demonstratë të madhe kundër luftës. Ndërkohë grupi apo lëvizja më e madhe antiglobaliste siç është ATTAC – Shoqata për Taksimin e Transaksioneve Financiare dhe Ndihma për Qytetarët (*Association pour la Taxation des Transactions Financière et l'Aide aux Citoyens, Association for the Taxation of Financial Transactions and Aid to Citizens*), ka krijuar degë në më shumë se 30 vende dhe zhvillon fushata të ndryshme të ndërgjegjësimit publik për drejtësinë fiskale si psh atë për të ashtuquajturën taksa Tobin.¹⁸

Ndërkohë si rezultat i masave të ashpra financiare gjatë krizës financiare në Europë, që preku kryesisht vendet e Europës Jugore si Spanja, Franca, Italia, Greqia e Portugalia, u krijuan lëvizje sociale (qytetare) që protestonin vazhdimisht kundër

18 Kolb, F. (2004) The Impact of Transnational Protest on Social Movement Organizations: Mass Media and the making of ATTAC Germany. In della Porta, D. and Tarrow S. (eds.) Transnational protest and global activism

masave të ashpra shtrënguese të kursimit. Një nga lëvizjet më të njohura ishte Lëvizja 15 M (*Movimento 15 M*) dhe Lëvizja e të Indinjuarve (*Indignados Movement*) që lindi në Spanjë, falë rrjeteve sociale që krijuan platforma dixhitale si Demokracia Reale TANI (*Democracia Real YA*) dhe Lëvizja Rinia pa Të Ardhme (*Youth Without a Future Juventud Sin Futur*). Ato ftuan qytetarët e të rinjtë spanjollë në 40 qytete në protestë më 15 maj 2011¹⁹ dhe deri në vitin 2014 rreth 6 milion spanjollë morën pjesë në protesta në të gjithë qytetet e Spanjës, duke kërkuar punë, arsim dhe të drejtat sociale. Si rezultat i kësaj lëvizje në 16 janar 2014 lindi partia *Podemos* e drejtuar nga studiuesi i shkencave politike Pablo Iglesias Turrión që tashmë është pjesë e skenës politike spanjolle dhe e qeverisë së koalicionit në Spanjë të drejtuar nga kryeministri Pedro Sances. Në Greqi, si rrjedhojë e kësaj fryme që solli Lëvizja e të Indinjuarve, partia e majtë Syriza nën drejtimin e liderit Alexis Cypras fitoi zgjedhjet parlamentare të vitit 2015 dhe shërbeu si kryeministër i Greqisë nga 21 Shtator 2015 deri në 8 korrik 2019.²⁰ Ndërsa në Itali u formua më 4 tetor 2009 Lëvizja 5 Yje (*Five Star Movement Movimento 5 Stelle*) që është aktualisht partia më e madhe në Itali, e krijuar nga komediani e blogeri Beppe Grillo dhe strategu i faqeve web Gianroberto Casaleggio dhe konsiderohet si një lëvizje populiste, anti establishment, pro mjedisore dhe euroskeptike. Që prej zgjedhjeve parlamentare të 2013 ajo është partia e dytë më e madhe në Itali dhe aktualisht bashkëqeveris në një koalicion të qendrës së majtë.²¹

Eksperiencia e lëvizjeve sociale në vendet e Europës Perëndimore pas viteve 90 ka dëshmuar se sukcesi i tyre ka qenë i lidhur ngushtësisht me gjerësinë e shtrirjen e tyre së bashku me masivitetin, strategjitë e protestës e këmbënguljen e vazhdueshme. Nga ana tjetër, tradita e konsoliduar e demokracisë në këto vende ka lehtësuar të ashtuquajturin 'moment të mundësisë politike' për suksesin e këtyre lëvizjeve, ku vetëdija publike është e lartë dhe sistemi politik reagon në mënyrën e duhur.

Edhe vendet e Europës Qëndore e Lindore kanë patur një traditë të lëvizjeve sociale, qytetare, edhe gjatë periudhës së sundimit

19 Donatella della Porta; Hara Kouki; Joseba Fernandez (2017). "Left's Love and Hate for Europe: Syriza, Podemos and Critical Visions of Europe During the Crisis". In Manuela Caiani; Simona Guerra (eds.). *Euroscepticism, Democracy and the Media: Communicating Europe, Contesting Europe*. Palgrave Macmillan UK. p.236. ISBN 978-1-137-59643-7

20 Idem

21 Bordignon, Fabio; Ceccarini, Luigi (26 March 2014). "Protest and project, leader and party: normalisation of the Five Star Movement". *Contemporary Italian Politics*. 6 (1): 54- 72.

komunist. Përgjatë viteve 1945-1990 lëvizje të tilla si Pranvera e Pragës, Klubi Petëf, Solidanorst, etj., dëshmuar për vetëdijen qytetare kundër regjimeve autoritare komuniste dhe si rrjedhojë, këto lëvizje u bënë bërthama e protestave masive që çuan në rrëzimin paqësor të regjimeve komuniste apo '*Revolucionin e Kadifejtë*' (Velvet Revolution) veçanërisht në vendet e Europës Qëndrore.²²

Ndërkohë Lëvizjet sociale (qytetare) në vendet e Europës Qëndrore e Lindore (EQL) pas viteve 90' kishin në qendër të vëmendjes aspekte të mirëqeverisjes, veçanërisht luftën kundër korrupsionit dhe abuzimit me pushtetin, që u shndërrua në tipar thelbësor të demokracive të reja të EQL pas rënies së komunizimit.²³ Një lëvizje masive qytetare kundër fenomenit të korrupsionit dhe keqqeverisjes përjetoi Sllovenia gjatë protestave apo '*revoltave të Mariborit*' nga 2 nëntor 2012 - 4 shkurt 2013, ku mijëra qytetarë të Mariborit dhe të qyteteve të tjera të Sllovenisë u ngritën në një lëvizje masive pasi Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit në Republikën e Sllovenisë akuzoi për korrupsion kryebashkiakun e Mariborit Franc Kangler, liderin e partisë qeverisëse Janez Jansa dhe liderin e opozitës Zoran Jankovic. Si rezultat i kësaj lëvizje, kryebashkiaku i Mariborit Franc Kangler dha dorëheqjen por, mbi të gjitha, vetëdija e qytetarëve sllovenë u rrit më tej ndaj fenomeneve të korrupsionit dhe keqqeverisjes.

Ndërsa në të njëjtën periudhë, Bullgaria ishte dëshmitare e një lëvizje të gjerë qytetare në Sofje, nga 28 maj 2013 deri në 22 korrik 2014, që çoi në dorëheqjen e qeverisë Oresharski së koalicionit të majtë.²⁴ Lëvizja Me Mua (*With Me*) u inicua përmes Facebooku-ut dhe ishte e lidhur me aspektet e luftës kundër korrupsionit, keqqeverisjes dhe konfliktit të interesit, veçanërisht të lidhjeve korruptive mes botës së biznesit, medias e politikës siç ishte rasti i emërimit të manjatit të medias Delyan Peelevski në krye të Agjencisë Kombëtare të Sigurimit të Bullgarisë, që falë protestave masive, u dorëhoq. Ndërkohë kjo lëvizje sociale (qytetare) ishte paraprirë nga protestat e 28 janarit 2013 në Blagoevgrad kundër çmimit të lartë të faturave të energjisë dhe

22 Daniels, R. V. (2000) The Anti-Communist Revolutions in the Soviet Union and Eastern Europe 1989-1991. In D. Parker (Ed.) *Revolutions and the Revolutionary Tradition in the West 1560-1991*. London: Routledge, pp. 202-24.

23 Sava, I. N. (2015) A second generation of grassroots movements in central and eastern Europe? *Open Democracy*, May 11, <https://www.opendemocracy.net/ionel-n-sava/second-generation-of-grassroots-movements-in-central-and-eastern-europe>

24 Tsoneva, Jana (2017) Vectors of Ex / Inclusion in Bulgarian Civil Society Post-2013 in Jasmin Mujanović (ed.), 2017, *The Democratic Potential of Emerging Social Movements in Southeastern Europe*, 68 pages (page 11-17)

të ujit, për shkak të monopolit në këtë sektor, ku si rrjedhojë lëvizja qytetare u shtri më pas në 30 qytete të Bullgarisë dhe përfundoi me dorëheqjen e qeverisë së Bojko Borisovit më 20 shkurt 2013.

Lëvizja qytetare Korrupsoni vret (*Corruption kills*) e themeluar në Rumani nga aktivisti Florin Badita ndërmori një sërë protestash gjatë periudhës 2017-2019 ku përgjatë dy fazave 18 janar – 5 mars 2017 dhe 23 gusht 2017-10 gusht 2019, u organizuan një sërë protestash kundër vendimit të Ministrisë së Drejtësisë së Rumanisë për të ndryshuar dispozitat e Kodit Penal që zbusnin dënimet për personat e përfshirë në korrupsion.²⁵ Aktivistët e kësaj lëvizjeje, me 1 dhe 5 shkurt 2017, organizuan protesta në Bukuresht me pjesëmarrjen e 300,000-500,000 qytetarëve dhe e vazhduan atë pareshtur derisa më 10 gusht 2018 një protestë: Diaspora në Shtëpi (*Diaspora at Home*) e organizuar nga rumunët që banonin jashtë vendit, bëri të mundur që qeveria rumune të tërhiqej dhe ish-ministri i drejtësisë Florin Iordache të jepte dorëheqjen.²⁶ Kjo lëvizje ishte pjesë e Lëvizjes së të Indinjuarve (*Indignados' Movement*) që u pasuan me protesta e lëvizje të ngjashme solidariteti në Moldavi e Bullgari, Serbi e Mal të Zi, Hungari e Sllovaki gjatë vitit 2017.

Edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor apo Europës Juglindore ka përjetuar valën e një sërë lëvizjesh sociale (qytetare) pas viteve 90 që kishin në qendër kundërshtimin ndaj praktikave të qeverisjes autoritare, zgjedhjeve të lira, keqqeverisjes, luftën kundër korrupsionit dhe elitave që abuzonin me pushtetin.

Lëvizjet sociale (qytetare) në Serbi e kanë zanafillën që në periudhën 17 nëntor 1996 - 22 mars 1997, kur studentët e Universitetit të Beogradit bashkë me partitë opozitare u bashkuan me Lëvizjen Së bashku (*Zajedno*), për të kundërshtuar mashtrimet elektorale në zgjedhjet lokale dhe ku si rrjedhojë e ketyre lëvizjeve ish-presidenti Miloshevic më 11 shkurt 1997 pranoi fitoren e opozitës në këto qytete.²⁷ Në vitin 1998 kjo lëvizje u pasua nga lëvizja e studentëve Rezistenca, (*Otpor*), që bëri thirrje për përmbyshjen e Miloshevicit dhe nxiti protesta në

25 http://eprints.bournemouth.ac.uk/29647/1/romanian_protests_2017_publication_FINAL_nk.pdf

Romania's 2017 anti-corruption protests: causes, development and implications PUBLISHED BY: Quadriga University of Applied Sciences, edited by Ana Adi & Derren Llicker Berlin ISBN 978-3-942263-48-1, 154 pages

26 Stoiciu, Victoria (2017) Romania's Years of Turmoil, 2012–2015 in Jasmin Mujanović (ed.), 2017, The Democratic Potential of Emerging Social Movements in Southeastern Europe, 68 pages (page 7-11)

27 Knezic, Marko (2017) Social Movements and Democratization in Serbia since Milošević in Jasmin Mujanović (ed.), 2017, The Democratic Potential of Emerging Social Movements in Southeastern Europe, 68 pages (page 23-27)

të gjithë Serbinë. Kulmi i kësaj lëvizje arriti gjatë të ashtuquajturit “Revolucioni Buldozer” (*Bager Revoliciaj*) kur pas zgjedhjeve presidenciale të 24 shtatorit 2000, lëvizja e gjerë qytetare bëri të mundur që më 5 tetor ish-presidenti Miloshevic të jepte dorëheqjen, duke i dhënë fund një periudhe të gjatë sundimi politik autoritar. Gjithashtu, përgjatë viteve 2018-2020 në Serbi u zhvilluan lëvizje të gjera sociale (qytetare) edhe me mbështetjen e opozitës të quajtura Stop Këmishave të Përgjakura (*Stop Bloody Shirts*) apo siç njihen ndryshe Lëvizja 1 në 5 Milion (*One of Five Million Jedan od pet miliona*) duke u bërë një nga lëvizjet protestuese qytetare më të gjata në Europë kundër keqqeverisjes, korrupsionit dhe autoritarizmit, veçanërisht duke i kundërvënë qeverisë dhe presidentit aktual Aleksandër Vucic.

Për shkak të papunësisë, korrupsionit dhe keqqeverisjes, lëvizja qytetare UDAR, kryesisht në Federatën e Bosnje Hercegovinës, zhvilloi një sërë protestash nga 4 shkurti 2014 deri në 25 prill 2014 ku protestat më masive u zhvilluan nga 4-10 shkurt 2014.²⁸ Ato filluan në qytetin verior të Tuzlas për tu përhapur në qytete të tjera si Sarajeva, Zenica, Mostari, Jajce e Brcko duke kërkuar dorëheqjen e qeverisë. Për shkak të masivitetit të tyre ato u krahasuan nga media të huaja me Pranverën Arabe apo Pranverën e Pragës, por në fund të Prillit 2014 ato u ngadalësuan dhe u ndërprenë dhe nuk arritën të realizojnë qëllimin e tyre, përveçse ndërgjegjësimit të opinionit publik për situatën social ekonomike dhe keqqeverisjen në këtë shtet.

Së fundmi është botuar një studim mbi angazhimin social/lëvizjet qytetare në Ballkanin Perëndimor: *Potenciali demokratik i lindjes së lëvizjeve sociale në Europën Juglindore (2017)* botim i Fondacionit Friedrich Ebert.²⁹ Botimi argumenton se aktivizmi social përgjatë rajonit të Ballkanit ka patur sukses përse i përket peshës dhe rolit që ato kanë patur në hapësirën publike përmes mënyrave të ndryshme dhe krijuese, por ende mbetet një problem mungesa e empatisë dhe solidaritetit me ta. Përse kohë strukturat politike në rajon nuk dëshmojnë përfaqësimin e duhur, lind nevoja që ato të ndryshohen apo të ribëhen në mënyrë që tu shërbejnë nevojave të shoqërisë. Përmes këtij botimi vërehet perceptimi i përbashkët se ka nevojë për të punuar me komunitete më të vogla, me qëllim për të ndërtuar besim dhe mbështetur

28 Eminagic, Emin (2017) Towards a De-Ethnicized Politics: Protests and Plenums in Bosnia and Herzegovina in Jasmin Mujanović (ed.), 2017, *The Democratic Potential of Emerging Social Movements in Southeastern Europe*, 68 pages, 23-27.

29 <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/sarajevo/13781-20171201.pdf>
Mujanović, Jasmin (ed.), 2017, *The Democratic Potential of Emerging Social Movements in South-eastern Europe*, 68 pages

forcat e ndryshimit. Në këtë kuadër është edhe botimi i studimit *Lëvizjet sociale në Ballkan. Rebelimi e Protestat nga Maribori në Taksim (2018)*³⁰, si përmbledhje e punimeve të Konferencës Ndërkombëtare që u organizua nga Qendra për Studimet e Europës Juglindore nga Universiteti i Gracit, ku qëllimi kryesor ishte të pasqyronte valën e gjerë të zemërimit e pakënaqësisë që kishte nxitur këto protesta si dhe për të ofruar një shpjegim për dështimin apo suksesin e tyre. Nga ana tjetër shfaqja e partive të reja që po sfidojnë partitë tradicionale po shërbejnë si forca transformuese të hapësirës politike të vendeve të tyre. Ato kanë shërbyer për të të nxitur ndryshime të mundshme, ku falë krizës ekonomike që goditi vende të ndryshme të Europës jugore pas vitit 2008, lëvizje të tilla si Syriza në Greqi, lëvizja 5 Yjet në Itali apo Podemos në Spanjë, sikurse homologët e tyre në Europën veriore siç është Aleanca për Gjermaninë, kanë qenë në gjendje të sfidojnë sistemet politike duke ndërthurr elementë të së majtës së re mbi demokracinë pjesëmarrëse me thirrjet radikale populiste të partive të djathta. Qasja e këtyre sfiduesve të sistemeve tradicionale politike ekonomike të Europës është e ndryshme, por ata kanë vënë një theks të fortë mbi çështjet ekonomike apo politike, që sot shqetësojnë Europën.

2.2. TEORITË E LITERATURA MBI STUDIMIN E LËVIZJEVE SOCIALE

Lëvizjet sociale, sipas studiuesit Mario Dani³¹ janë pak a shumë të lidhura me plotësimin e 3 kriterëve si “ekzistenca e një rrjeti ndërveprimi informal mes një shumice individësh, grupesh dhe organizatash, të përfshirë në konflikt kulturor apo politik në bazë të një identiteti të përbashkët kolektiv.” Ndërkohë sociologu Charles Tilly³² i përkufizon lëvizjet sociale/qytetare si një seri manifestimesh dhe fushatash kundërvënëse përmes të cilave njerëzit e zakonshëm shfaqin pretendimet e tyre. Për Tilly, lëvizjet sociale janë mjeti kryesor që njerëzit e zakonshëm të marrin pjesë në politikën publike. Sipas tij kemi 3 elementë themelorë që i karakterizojnë këto lëvizje, siç janë 1) fushatat; 2) lista e çështjeve të debatueshme, takimet publike, peticionet, deklarat

30 Bieber, Florian; Brentin, Dario (2018, ed) *Social Movements in the Balkans. Rebellion and Protest from Maribor to Taksim*, Centre for Southeast European Studies (CSES), University of Graz, Austria.

31 Della Porta, D. and Diani, M. (1999) *Social Movements: An Introduction* Oxford: Blackwell; Diani, Mario (1992). “The concept of social movement”. *The Sociological Review*. 40 (1): 1–25. ISSN 0038-0261

32 Tilly, Charles. (1978) *From Mobilization to Revolution*. Reading, Massachusetts: Addison-Wesley.

në media dhe pamfletet; dhe 3) shfaqja e të ashtuquajturës WUNC (vlerat, bashkimi, anëtarësia dhe angazhimi). Sidney Tarrow³³ i përcakton lëvizjet sociale si një sfidë ndaj elitave, autoriteteve, grupeve të tjera apo normave dhe vlerave kulturore nga njerëz që kanë qëllime të përbashkëta e vepronë në solidaritet përballë elitave kundërshtarë dhe autoriteteve. Ai dallon në mënyrë të dukshme lëvizjet sociale nga partitë politike dhe grupet e advokatisë. Kurse sociologët John McCarthy dhe Mayer Zald e përcaktojnë lëvizjen sociale (qytetare) si një “tërësi opinonesh dhe besimesh që përfaqësojnë parapëlqimin e një grupi njerëzish, komuniteti apo shoqërie për të ndryshuar disa elementë të strukturës sociale.”³⁴

Ndërsa sipas Paul van Seeters dhe Paul James³⁵ një lëvizje sociale (qytetare) përkufizohet pas plotësimit të një sërë kushtesh minimale për tu mbledhur së bashku, siç është krijimi i një lloji identiteti kolektiv, orientimi i përbashkët dhe qëllimi për të ndryshuar status-kuonë e një situatë, norme, ligji, vendimi apo sjellje institucionale. Në këtë rast, ka rëndësi që veprimet praktike të jenë të lidhura së bashku përgjatë gjithë kohës, duke patur parasysh se lëvizjet sociale (qytetare) trajtojnë shqetësimet përballë publikut.

Kështu, përkufizimi i një lëvizje sociale lidhet me një formë organizimi politik ku individët që marrin pjesë në të kanë vetëdijen e plotë se janë bashkuar për një qëllim të përbashkët. Për këtë qëllim çdo veprim duhet të synojë të sjellë ndryshimin e duhur social sipas synimeve apo objektivave që të gjithë kanë rënë dakort. Studiuesit e shumtë kanë vërejtur se lëvizjet sociale (qytetare) karakterizohen nga tipologji të ndryshme që lidhen me qëllimin dhe nivelin e mobilizimit e përfshirjes së masave qytetare për të realizuar objektivat e tyre. Ata bëjnë një klasifikim tjetër të lëvizjeve sociale (qytetare) në vartësi të llojit të ndryshimit që ato duan të sjellin në shoqëri siç janë lëvizjet që duan të ndryshojnë norma të caktuara në komunitetet e tyre si lëvizjet liberale apo lëvizjet konservatore që duan të ruajnë norma apo vlera të caktuara sociale si kanë qenë lëvizjet ludite të shek. XIX kundër teknologjisë, lëvizjet antiabort apo ato kundër OMGJ.³⁶

33 Sidney Tarrow, *Power in Movement: Collective Action, Social Movements and Politics*, Cambridge University Press, 1994. ISBN 0-521-42271-X

34 McCarthy, John; Zald, Mayer N. (May 1977). "Resource Mobilization and Social Movements: A Partial Theory". *American Journal of Sociology*. 82 (6): 1212–1241

35 James, Paul; van Seeters, Paul (2014). *Globalization and Politics, Vol. 2: Global Social Movements and Global Civil Society*. London: Sage Publications.

36 Suzanne Staggenborg (2008), *Social Movements*, Oxford University Press. ISBN 978-0-19-

Një element dallues i këtyre lëvizjeve janë grupet shoqërore që ata kanë në qendër të aktivitetit të tyre, ku mund të përfshihen lëvizje që kanë në qendër të aktivitetit grupe apo individë. Gjithashtu metodat që përdorin këto lëvizje sociale për të arritur objektivat e tyre i kanë ndarë ata në lëvizje të dhunshme apo paqësore, që përdorin mjetet paqësore të protestës të ashtuquajtura si rezistenca jo e dhunshme.

Lëvizjet sociale kanë një traditë të gjatë historike dhe kanë ekzistuar prej shumë shekujsh. Shumica e këtyre lëvizjeve të hershme datojnë që prej shek. XVIII dhe XIX, që kishin në qendër të veprimtarisë së tyre grupe të veçanta sociale siç ishin klasa punëtore, fshatarët dhe minoritetet e ndryshme. Ata kanë qenë të grupuara rreth disa qëllimeve me natyrë materialiste që lidheshin me këto grupe, ku përfshihej përmirësimi i standarteve të jetës, të drejtat e pronës, votës etj. Ndërkohë lëvizjet e reja sociale u bënë mbizotëruese në gjysmën e dytë të shek. XX ku shembujt më domethënës janë lëvizjet për të drejtat civile, feministe, mjedisore, çarmatimit që janë të përqëndruara rreth një çështje të caktuar dhe interesat e qëllimet e tyre janë përtej interesave të një grupi të veçantë të shoqërisë. Në këtë kuadër, shtrirja e tyre gjeografike është e ndryshme. Mes tyre mund të dallojmë lëvizje sociale të nivelit global si Forumi Social Botëror (World Social Forum), Veprimi Global i Njerëzve (*Peoples Global Action*), Jo Globalizëm (*No Global*) apo të nivelit lokal që kanë objektiva e synime që shtrihen brenda një territori që i përket një vendi të caktuar, si psh Lëvizja e Sheshit Taksim në Stamboll për mbrojtjen e Parkut Gazi, Pushtoni Wall Street (*Occupy Wall Street*) apo lëvizje të tjera të ngjashme në vende të ndryshme.

Studiues të ndryshëm flasin për ciklin jetësor të lëvizjeve sociale (Blumer, 1969) Maus (1975), Tilly (1978)³⁷, ashtu siç pasqyrohet në çdo qenie të gjallë që lind, zhvillohet dhe më pas vdes. Edhe lëvizjet sociale kanë ciklin e tyre jetësor teksa krijohen, zhvillohen, arrijnë të kenë sukses apo të dështojnë dhe më pas ato shpërbëhen dhe pushojnë së ekzistuari apo shndërrohen në parti politike në raste të caktuar si psh Lëvizja 5 Yjet (*Movimevento Cinque Stelle*) në Itali. Lëvizjet sociale evoluojnë sipas kohës dhe vendit, çka lidhet me përhapjen e ideve të shek. XIX për të drejtat e individit, lirinë e shprehjes dhe mosbindjes civile. Eksperienca historike e këtyre lëvizjeve ka treguar se ato shfaqen në shoqëritë liberale e autoritare në

542309-9

37 Tilly, Charles. (1978). From Mobilization to Revolution. Reading, Massachusetts: Addison-Wesley.

forma të ndryshme për të arritur objektiva të caktuar në varësi të rrethanave që kushtëzojnë lindjen e zhvillimin e tyre. Siç pohon sociologu Neil Smelser³⁸, lindja e një lëvizje sociale (qytetare) ka nevojë për një ngjarje fillestare, një ngjarje që krijon një reagim zinxhir dhe mund të jetë shkak për këto lëvizje. Shkaku është hapi i parë i lindjes së një lëvizje sociale (qytetare), që pasohet nga formimi i qëndrueshëm, organizimi e që më pas lidhet me aktivitetin e saj. Në këtë rast, çdo lëvizje sociale (qytetare) mund të përfundojë me sukses apo dështim, në vartësi të kushteve, mjeteve të përdorura, nivelit të mobilizimit qytetar dhe reagimit institucional, për t'ju përgjigjur ndryshimit që kërkohet nga këto lëvizje.

Historia e zhvillimit të lëvizjeve sociale (qytetare) ka prodhuar një literaturë të pafundme e të shumtë për studimin e tyre, që pasurohet në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me format e strategjitë që ndjekin këto lëvizje. Si rrjedhojë, studiuesit kanë zhvilluar një sërë teorish lidhur me studimin e tyre, ku disa nga teoritë më të njohura përfshijnë që nga teoria marksiste (1880), teoritë e veprimit apo sjelljes kolektive (1950)³⁹, teoritë e shtypjes relative (1960), teoria e vlerës së shtuar (1960), teoria e mobilizimit të burimeve (1970),⁴⁰ teoria e procesit politik (1980), teoria kuadër (1980) e lidhur ngushtë me teorinë konstruksioniste sociale (1980) apo teoria e lëvizjes së re sociale (1980).⁴¹ Ato vazhdojnë të përditësohen vazhdimisht përmes qasjeve e koncepteve të reja për shkak të këndvështrimit të këtyre lëvizjeve nga studiues të shkencave politike, të sociologjisë, psikologjisë, medias etj.

38 Smelser, Neil J (1962). *Theory of Collective Behavior*, Free Press, Glencoe, Ill., 1962

39 Miller, David L (2000). *Introduction to Collective Behavior and Collective Action*, Prospect Heights, IL: Waveland Press, 2000 2d edition.

40 Piven, Francis; Cloward, Richard (Summer 1991). "Collective Protest: A Critique of Resource Mobilization Theory". *International Journal of Politics, Culture, and Society*; 4 (4): 435-458

41 Buechler, Steven M (1995). *New Social Movement Theories*, *Sociological Quarterly* Volume 36 Issue 3, Pages 441 - 464, 1995.

3. METODOLOGJIA

Përzgjedhja e qarqeve: Mbështetur në studime të mëparshme dhe në bashkëpunim me Westminster Foundation for Democracy Albania, ekipi kërkimor përzgjodhi për këtë studim qarqet: Shkodër, Kukës, Dibër, Tiranë, Korçë, Fier e Vlorë. Përzgjedhja e tyre bëri të mundur përfaqësimin e a) të gjitha qarqeve të vendit; b) banorëve të zonave urbane, semi-urbane dhe rurale; c) niveleve të ndryshme të zhvillimit socio-ekonomik, veçanërisht që nga fillimi i tranzicionit post -socialist; d) formave të ndryshme të ekonomisë dhe zhvillimit të proceseve sociale. Për secilin nga qarqet e përzgjedhura, u mbledhën dhe u analizuan informacione nga kategori të ndryshme individësh, si burra, gra, të rinj dhe të moshuar.

Teknikat sasiore dhe cilësore të studimit: Puna analitike për realizimin e këtij studimi përfshiu analizën e të dhënave nga burime parësore e dytësore. Ajo përfshiu: një shqyrtim të literaturës ekzistuese, metoda sasiore e cilësore (kryqëzimi i të dhënave). Elementi i metodave sasiore e cilësore përfshiu: a) diskutime me fokus grupe qytetarësh që ishin votues dhe me anëtarë të lëvizjeve/organizatave qytetare; b) intervista gjysëm të strukturuar me qytetarë dhe drejtues të lëvizjeve; dhe një c) pyetësor për anketimin socioekonomik të 1018 qytetarëve, i cili kishte 20 grupe pyetjesh.

3.1 PËRSHKRIMI I TEKNIKAVE TË STUDIMIT

Shqyrtimi i literaturës. Ekipi kërkimor realizoi një shqyrtim të literaturës që lidhej me lëvizjet sociale në Europën Perëndimore, Europën Qendrore e Lindore dhe ato në vendet e Europës Juglindore apo të Ballkanit Perëndimor. Të gjitha burimet e përdorura janë të listuara në bibliografi.

Diskutimet me Fokus-Grupe: Anëtarët e ekipit kërkimor realizuan diskutime me fokus-grupe duke përdorur pyetje gjysëm të strukturuar që u hartuan në bashkëpunim me Westminster Foundation for Democracy Albania. Kjo teknikë bëri të mundur një diskutim më të gjerë dhe të hapur dhe përmes tyre u a) grumbullua informacion mbi perceptimet e qytetarëve rreth aktorëve të rinj potencialë të politikës; b) vlerësuan kapacitetet e këtyre lëvizjeve sociale (qytetare) për të mobilizuar qytetarët dhe

për tu bërë aktorë të besuar në jetën politike; c) kuptua historia, aktivizimi, anëtarësia, misioni, objektivat dhe planet e tyre afatmesme e afat-gjata. Të gjithë fokus grupet u regjistruan dhe më pas u transkriptuan. Ekipi kërkimor realizoi 6 fokus grupe (1 për secilin qark), ku u përfshinë individë në moshë votimi. Fokus grupet përbëheshin nga banorë të zonave urbane, semi-urbane dhe rurale. Cdo grup përbëhej nga 7-12 individë të ndryshëm nga pikpamja moshore, gjinore, nivelit arsimor dhe socio-ekonomik. Gjatë këtyre diskutimeve janë përdorur pyetje të hapura si: 'Sa të kënaqur jeni me këto lëvizje?', 'Cili është impakti më i dukshëm i këtyre lëvizjeve?' dhe 'Cfarë mund të bëhet për të përmirësuar impaktin e tyre në shoqëri?'. Mbështetur në përgjigjet e dhena, u qartësuan perceptimet dhe qëndrimet e tyre mbi këto lëvizje.

Gjithashtu u realizuan edhe fokus grupe me përfaqësuesit e anëtarët e këtyre organizatave/lëvizjeve.

Intervista gjysëm të strukturuar – 30 intervista gjysëm të strukturuar u realizuan me qytetarë në moshë votimi në secilin nga qarqet e përzgjedhura (5 në secilin qark). Pyetjet e intervistave u hartuan në mënyrë që të bëhej i njohur perceptimi i qytetarëve rreth aktorëve të rinj politikë në Shqipëri. Gjithashtu, u kryen 12 intervista gjysëm të strukturuar me përfaqësues të secilit prej këtyre lëvizjeve/organizatave qytetare. Pyetjet gjysëm të strukturuar u hartuan nga ekipi kërkimor në konsultim me Westminster Foundation for Democracy Albania.

Pyetësorët Socioekonomikë – Për të kryqëzuar informacionin dhe për të marrë të dhëna sasiore, grupi i kërkuesve përdori pyetësorë me qytetarë shqiptarë në moshë votimi. Për këtë qëllim u anketuan *ballë për ballë* 1018 qytetarë në të 6 qarqet e përzgjedhura. Anketa përmbante 20 grupe pyetjesh që synonin të prodhonin të dhëna sasiore lidhur me perceptimin e qytetarëve për këto lëvizje dhe ndikimin e tyre për të nxitur mobilizimin social dhe përfshirjen në politikëbërje.

Numri i anketave me qytetarët shqiptarë në secilin qark ishte në përpjestim të drejtë me madhësinë e popullsisë së tyre.

Metoda sasiore u përcaktua si më poshtë:

- a) para fillimit të anketimit në terren, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, u përcaktua numri popullsisë në secilin qark;
- b) në bazë të numrit të popullsisë, u përlogarit përqindja e anketave që do të realizoheshin në secilin qark;
- c) të dhënat e marra tregonin numrin e anketave që do të realizoheshin në secilin qark;

Tabela 1. Shpërndarja e anketave sipas qarqeve

Nr	Qarku	Popullsia	Përqindja	Numri i anketave	Urbane	Rurale
1	Shkodra	200.007	10.1	101	60	41
2	Kukës/ Dibra	191.285	9.7	98	59	39
3	Tirana	906.166	45.7	457/411	365	92
4	Korca	204.831	10.3	103	65	38
5	Fieri	289.889	14.6	146	100	46
6	Vlora	188.922	9.5	95	60	35
	Totali	1.981.100	100	1000	709	291

Burimi: INSTAT., Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2020 http://www.instat.gov.al/media/6849/popullsia_me-1_janar_2020.pdf

- (d) në secilin qark anketimi u krye në qytetin kryesor të tij, në një qytet më të vogël, dhe në zonat rurale (u përzgjedhën 2-3 fshatra, afër dhe larg nga qyteti);

Tabela 2. Përzgjedhja e qytetit kryesor dhe sekondar në secilin qark

Nr	Qarku	Qyteti kryesor	Qytet i vogël
1	Shkodra	Shkodër	Vau i Dejës
2	Kukës/Dibra	Kukës	Bulqiza
3	Tirana	Tirana	Kamëz/Vorë
4	Korca	Korçë	Pogradec
5	Fieri	Fier	Lushnje
6	Vlora	Vlorë	Selenice

(e) personat e intervistuar u përzgjedhën rastësisht në pjesë të ndryshme të qytetit, kryesisht në rrugë ose në biznese lokale (dyqane, bar-kafe, restorante, etj). Anketimi përfshiu gjithashtu edhe individë nga grupe të ndryshme etnike. Gjatë procesit të anketimit, anketuesit u përpoqën të ruajnë në mënyrë të qëllimshme balancën gjinore dhe midis grup-moshave. Të dhënat sasiore të grumbulluara u koduan, u hodhën në kompjuter dhe u përpunuan në SPSS (Statistical Package for Social Sciences) nga një person që kishte eksperiencë me CESS. Pas hedhjes dhe kontrollit të të dhënave, u realizua analiza e tyre.

4. REZULTATET E ANKETËS

4.1. GJETJET KRYESORE NGA ANKETA

Vlerësimi i rolit dhe peshës së lëvizjeve sociale apo qytetare në Shqipëri u realizua përmes anketës së zhvilluar në 7 qarqet e Shqipërisë: Tirana, Fieri, Vlora, Korça, Dibra, Kukësi e Shkodra. Janë pyetur 1018 individë të moshave, profesioneve e nivele të ndryshme të arsimit lidhur me perceptimin e tyre mbi lëvizjet qytetare apo sociale si Nisma Thurrje, Alternativa, Organizata Politike, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, Vetëvendosja dhe EcoAlbania. Lidhur me shkallën e njohjes që ata kanë për këto lëvizje që zhvillojnë aktivitet në vend, në bazë të të dhënave rezultoi një nivel i ulët informacioni dhe njohurish për to. Kështu 80.1% e tyre shprehen se nuk e njohin lëvizjen Organizata Politike, 79.4% lëvizjen Alternativa, 62.8%. Nismën Thurje dhe 59.3% EkoAlbania. Ndërkohë janë vetëm 22.8% e të intervistuarëve që shprehen se nuk kanë njohuri për lëvizjen Aleanca për mbrojtjen e Teatrit dhe 36.7% e tyre shprehen në të njëjtën mënyrë për lëvizjen Vetëvendosja (Tabela 3). Për shkak të aktivitetit të tyre më të lartë në publik, vëmendjes së medias dhe kohës kur është zhvilluar anketa, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit ka nivelin më të lartë të njohjes nga publiku në raport me lëvizjet e tjera, për të cilat janë pyetur të intervistuarit. Ndërsa në rastin e lëvizjes Vetëvendosje, niveli më i lartë i njohjes mund të lidhet më shumë me jehonën e medias për aktivitetet e kësaj lëvizje, tashmë parti politike në Republikën e Kosovës, se sa me veprimtarinë e degës së saj në Shqipëri. Megjithatë, janë 33% e individëve të intervistuar që pohojnë se njohja që ata kanë

për Aleancën Mbrojtja për Teatrin është minimale dhe 24.6% janë shprehur në të njëjtën mënyrë për lëvizjen Vetëvendosja, çka tregon se në përgjithësi lëvizjet që janë krijuar vitet e fundit nuk kanë mundur të njihen siç duhet nga qytetarët nëpërmjet aktiviteteve që kanë realizuar apo çështjeve që kanë mbrojtur.


Tabela 3. A i njihni lëvizjet e mëposhtme qytetare? (në %)

Nr	Lëvizjet Qytetare	Nuk e njoh	Minimale	E njoh	Shumë mirë	Maksimale
1	Nisma Thurje	62.8	22.5	10.5	1.9	2.3
2	Alternativa	79.4	14.3	4.0	1.2	1.1
3	Organizata Politike	80.1	14.3	4.0	1.2	0.4
4	Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit	22.8	33.0	27.3	9.6	7.2
5	Vetëvendosja	36.7	24.6	20.8	9.8	8.1
6	EcoAlbania	59.3	18.0	11.6	6.4	4.6

Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Në bazë të historisë së zhvillimit të lëvizjeve sociale apo qytetare, është vërejtur se një nga elementët kryesorë për të zgjeruar shkallën e njohjes së tyre mes komuniteteve ku ata veprojnë, është përdorimi i mjeteve të komunikimit, qoftë atyre tradicionale si mediat e shkruara dhe elektronike apo rrjetet sociale. Sipas rezultateve të anketës, 45.9% e personave të intervistuar janë shprehur se informacionin për këto lëvizje e marrin nëpërmjet TV (Figura 1). Shifra dëshmon se media tradicionale dhe veçanërisht TV që përcjellin informacione brenda 24 orëve si TV news, përbëjnë një element të rëndësishëm që bën të mundur shpërndarjen e informacionit për këto lëvizje tek individët e ndryshëm. Nga ana tjetër, janë 30% e të intervistuarve që shprehën se këtë informacion për lëvizjet qytetare apo lëvizjet sociale ata e marrin nëpërmjet rrjeteve sociale (Facebook, Instagram). Tashmë, pesha dhe roli i rrjeteve sociale për të shpërndarë informacione mbi aktivitetet dhe çështjet që ata mbrojnë, është rritur në mënyrë të ndjeshme, veçanërisht tek moshat e reja. Ata janë shndërruar në 'media në hije' - duke luajtur shpesh një rol të dorës së parë për të përcjellë informacion të drejtpërdrejtë, opinione, komente dhe për të matur peshën e ndikimit të tyre në shoqëri. Ndërkohë është vetëm 10.4% e individëve që janë shprehur se informacionin për këto lëvizje e kanë marrë nga aktivitetet që ato kanë zhvilluar në qytetet e tyre. Në këtë mënyrë, kjo përqindje dëshmon për një pjesëmarrje të ulët në këto lëvizje dhe një shtrirje e prani të pakët të tyre në rajonet kryesore të Shqipërisë.

Figura 1. Si e merrni informacionin për këto lëvizje (më shumë së një përgjigje)



Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Rëndësia e përdorimit të mediave tradicionale e rrjeteve sociale është e rëndësishme që lëvizjet sociale të përcjellin mesazhet e tyre tek publiku dhe të rrisin nivelin e ndërgjegjësimit. Këtë e pohon Saimiri, aktivist i lëvizjes EcoAlbania teksa argumenton se *‘ne jemi pak tradicionalë përsa i përket komunikimit me median duke i kushtuar vëmendje medias së shkruar dhe elektronike. Ne e ndjekim komunikimin e drejtpërdrejtë në terren, ku përfshijmë edhe përdorimin e mediave sociale, pasi kemi një person të specializuar për këtë punë që merret vetëm me komunikimin. Psh nëse ne dërgojmë një njoftim për shtyp në listën e kontakteve tona është e sigurt që do dali në dhjetë apo pesëmbëdhjetë media me të cilat kemi kontakte...’*.

Lidhur me nivelin e interesit që shfaqin individët e intervistuar për këto lëvizje në shtatë rajonet e përzgjedhura, vërejmë se mesatarisht afro 24.9% e tyre pohojnë se këto lëvizje nuk i tërheqin aspak. Një shifër e tillë pëlqimi mund të shpjegohet qoftë me indiferentizimin dhe apatinë sociale por edhe me faktin se çështjet që mbrojnë këto lëvizje si psh ruajtja e trashëgimisë kulturore, mbrojtja e mjedisit, ndryshimi i sistemit zgjedhor, siç janë ato që mbrohen nga lëvizje të tilla si Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, Nisma Thurrje, apo EcoAlbania, mund tu duken si “çështje elitare” përballë varfërisë, papunësisë, mungesës së

shërbimeve që ato ndjejnë në jetën e përditshme. Megjithatë për shkak të mediatizimit, protagonizmit dhe interesit të debatit apo veprimeve që kanë ngjallur një pjesë prej tyre në opinionin publik, janë thujse 27% e të intervistuarve që shprehen se i tërheq shumë Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, duke u pasuar me 19% nga lëvizja Vetëvendosja (Tabela 4).

Tabela 4. Sa ju tërheqin lëvizjet e mëposhtme? (në %)

Nr	Lëvizjet Qytetare	Shumë	Pak	Aspak	Nuk e njoh
1	Nisma Thurje	8.4	41.2	24.5	26.0
2	Alternativa	3.9	38.2	26.5	31.2
3	Organizata Politike	4.0	38.2	27.2	30.6
4	Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit	26.9	41.6	22.5	8.9
5	Vetëvendosja	19.0	44.3	24.8	11.9
6	EcoAlbania	12.1	41.6	23.9	22.4

Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Niveli i pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e këtyre lëvizjeve është shumë i ulët. Thujse 99% e të gjithë të intervistuarve që u pyetën nëse kanë marrë pjesë në aktivitetet e ndonjëres prej këtyre lëvizjeve, u përgjigjën në mënyrë mohuese (Figura 2). Kjo përqindje shumë e ulët mund të lidhet me një sërë faktorësh, në të cilën përfshihet kryesisht apatia sociale në shtresa të ndryshme të shoqërisë shqiptare, mungesa e kapaciteteve të këtyre lëvizjeve për tu shtrirë më gjerësisht në qytetet e vendit, apo siç përmendëm një lidhje jo shumë e fortë mes çështjeve që mbrojnë këto lëvizje dhe interesit më të drejtpërdrejtë të qytetarëve, siç është varfëria, papunësia, cilësia e dobët e shërbimeve publike, etj.

Figura 2. A merrni pjesë në aktivitetet e ndonjë prej këtyre lëvizjeve?



Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Njëherësh duhet të theksojmë se për shkak të pandemisë Covid 19, që prej 9 marsit të vitit 2020, aktiviteti i këtyre lëvizjeve sociale u ngadalësua ose u ndërpre plotësisht si rezultat i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe gjendjes së karantinës në të gjithë vendin nga ana e autoriteteve shtetërore.⁴² Por kjo periudhë përkoi me një nga ngjarjet kryesore ku u përfshi lëvizja Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, siç ishte prishja e godinës së Teatrit Kombëtar më 17 maj 2020 nga ana e Inspektoriatit të Ndërtimit, Urbanistikës dhe Kontrollit-INUK me mbështetjen e forcave të rendit. Kjo solli një përplasje fizike mes aktivistëve të lëvizjes Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, ku në mbështetje të aktivistëve u përfshinë edhe përfaqësues të opozitës joparlamentare siç ishin liderët dhe deputetët e Partisë Demokratike e Lëvizjes Socialiste për Integrim⁴³, me një pasqyrim e reagim të gjerë në median tradicionale dhe veçanërisht në rrjetet sociale.

Por nga ana tjetër edhe mungesa e burimeve njerëzore e financiare të këtyre lëvizjeve për të zgjeruar aktivitetin dhe fushatat e tyre ndërgjegjësuese kanë luajtur rolin e tyre në këtë pjesëmarrje apo mobilizim të ulët të masave qytetare.


Lidhur me financimin e këtyre lëvizjeve, ato janë të paqëndrueshme dhe mungesa e burimeve financiare e bën të vështirë shtrirjen e tyre në qytete të tjera. Siç pohon Arditi, anëtar lëvizjes Alternativa, *“Financimet kanë qenë të rastësishme, ose nëpërmjet kontakteve individuale duke takuar miq e shokë, biznesmenë që u kërkojmë të na ndihmojnë në forma të ndryshme, por mungesa e financimeve për të mbajtur një organizatë apo lëvizje për ne është e pamundur dhe është shumë e vështirë...”*.

Një faktor që mund të shpjegojë deri diku këtë nivel të ulët pjesëmarrje të publikut në aktivitetet e këtyre lëvizjeve është perceptimi i tyre se ato nuk janë të pavarura nga partitë politike. Thuajse 76% e atyre që janë intervistuar gjatë zhvillimit të kësaj ankete kanë pohuar se nuk besojnë se këto lëvizje janë të pavarura nga partitë kryesore (Figura 3). Në këtë mënyrë perceptimi i tyre për këtë mungesë pavarësie nxit një pasivitet të angazhimit qytetar dhe dëshmon shkallën e lartë të dyshimit dhe mosbesimit e ngulitur ndaj çdo përpjekje të tillë.

42 <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Akti-Normativ-nr-3-date-15-mars-Per-marrjen-e-masava-te-vecanta-administrative-gjate-kohezgjitjes-se-periudhes-se-infekcionit-te-shkaktuar-nga-COVID-19.pdf>

43 <https://www.zeriamerikes.com/a/5423205.html>-Shembet nga Bashkia Tiranë në orët e para të mëngjesit godina e Teatrit Kombëtar

Figura 3. A besoni se këto lëvizje janë të pavarura nga partitë kryesore?



Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Megjithatë shumica e tyre besojnë se çështjet që ata mbrojnë kanë rëndësi për komunitetin dhe ky është një tregues i rëndësishëm se pavarishtë nivelit të ulët të pjesëmarrjes në aktivitetet e tyre, vërehet një fenomen i shumicës së heshtur që mbështet këto lëvizje mes individëve që janë intervistuar për këtë qëllim. Kështu, mesatarisht 58.2% e të intervistuarve mendojnë se ato mbrojnë çështje me rëndësi për komunitetin. Siç vërehet edhe në Figurën 4, mbështetjen më të madhe e ka lëvizja Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, ku 71.5% pohojnë se çështja e tyre është e rëndësishme, duke u pasuar me 64.8% të atyre që mendojnë në të njëjtën mënyrë për çështjet që mbrojnë lëvizja Vetëvendosje, 56.7% dhe 56.1% pohojnë të njëjtën gjë për lëvizjet EcoAlbania dhe Nisma Thurrje, ndërsa thuhet 50% shprehen kështu për lëvizjet Alternativa dhe Organizata Politike.

Figura 4. A mendoni se kauzat që ato mbrojnë janë të rëndësishme për komunitetin?




Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Në të njëjtën kohë, kur pyeten për ndikimin që këto lëvizje kanë në jetën publike dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimarrje, 44.5% shprehen se ato kanë pak ndikim, ndërsa 32% pohojnë se ato nuk kanë aspak ndikim në këtë drejtim. Shifra të tilla dëshmojnë se në bazë të perceptimit të qytetarëve të intervistuar qëndron ideja se shkalla e pesha e tyre për të sjellë ndryshim është e papërfillshme teksa vetëm 14% e tyre mendojnë se këto lëvizje kanë shumë ndikim në jetën publike dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimarrje. Sërish vërejmë se Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit dhe lëvizja Vetëvendosje janë ato që mund ta sjellin këtë ndryshim duke patur parasysh se 23.7% dhe 20.9% e personave të intervistuar e kanë këtë ide lidhur me dy lëvizjet e sipërpërmendura (Figura 5).

Ndoshta një nga arsyet e këtij mosbesimi ndaj këtyre lëvizjeve nga ana e votuesve është se ata ndalen vetëm tek denoncimi pa ofruar zgjidhje që mund të frymëzonin qytetarët ta bashkëkoheshin atyre. Lidhur me këtë argument Martini, një aktivist tjetër i lëvizjes Alternativa shprehet *“jemi mësuar me Lëvizje apo parti politike që bëjnë vetëm denoncime. Është shumë e thjeshtë të bësh denoncime, nga mëngjesi deri në darkë. Problemi është që të japësh zgjidhjen. Po dhe zgjidhje pa një ideologji nga pas ato kthehen thjesht në zgjidhje populiste...”*.

Figura 5. Sa ndikim kanë në jetën publike dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimarrje këto lëvizje?



Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Por pavarësisht dyshimeve dhe mosbesimit që shfaqin personat e intervistuar lidhur me rezultatet që këto lëvizje sjellin në jetën

publike, është interesant fakti se kur ata pyeten sesi duhet të jetë aktiviteti i tyre në të ardhmen, 79.8 % përgjigjen se duhet të jetë, më i fortë. Në këtë rast vërehet prirja për të pranuar forma të reja të përfaqësimit e shprehjes së interesit publik përkundër sistemit të partive politike.

Tabela 5. Si mendoni se duhet të jetë aktiviteti i këtyre lëvizjeve në të ardhmen? (në %)

Nr	Lëvizjet qytetare	Më i fortë	Më i dobët	Njësoj
1	Nisma Thurje	79.3	7.7	13.1
2	Alternativa	78.9	7.9	13.3
3	Organizata Politike	78.4	8.2	13.5
4	Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit	82.2	6.5	11.3
5	Vetëvendosja	79.9	7.1	13.0
6	EcoAlbania	80.0	7.3	12.7

Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Ndërkohë sërish shfaqet në këto përgjigje për perceptimin e lëvizjeve qytetare i ashtuquajtur 'paradoksi i angazhimit pasiv social', pasi mesatarisht 89.7% e personave të intervistuar pohojnë se nuk duan të përfshihen në këto lëvizje (Figura 6). Nëse nga njëra anë shumica e personave të intervistuar kërkojnë që këto lëvizje të jenë më të forta, mungesa e dëshirës së tyre për të marrë pjesë në to nuk arrin të shpjegojë paradoksin sesi një lëvizje më e fortë qytetare mund të ketë sukses përmes angazhimit pasiv social dhe pjesëmarrjes së ulët.

Figura 6. A dëshironi të merrni pjesë në një nga këto lëvizje?



Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Megjithatë fusha ku shqiptarët shprehin në mënyrë të dukshme angazhimin e tyre social ka mbetur procesi elektoral që siç duket konsiderohet si kulmi i përfshirjes së tyre në përpjekjet për ndryshim apo për të mbrojtur interesat tyre. Kjo shprehet përmes fakti se rreth 80.9% e të intervistuarve në këto rajone kanë pohuar se do të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare çka dëshmon rëndësinë e proceseve elektorale si faza kryesore e shpesh herë e vetme përmes të cilave shprehet angazhimi social për shumicën e individëve që kanë marrë pjesë në këtë anketë (Tabela 6).

Tabela 6. A planifikoni të votoni në zgjedhjet e ardhshme?

Nr	Planifikimi për të votuar	Numër	Përqindje
1	Po	822	80.9
2	Jo	140	13.8
3	Nuk e kam vendosur	54	5.3
Total		1016	100

Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Por mungesa e interesit do të ishte shkak kryesor për 48.1% të personave të intervistuar kur janë pyetur se cila do të ishte arsyeja përse nuk do të merrnin pjesë në votime, çka vërteton se apatia sociale, për shkak të zhgënjimit dhe tranzicionit të stërzgjatur, qëndron në themel të këtij perceptimi që ushqen indiferencën elektorale.

Tabela 7. Nëse nuk do të votoni, cilat janë arsyet?

Nr	Arsyet që nuk do të votoni	Numër	Përqindje
1	Nuk kam kohë	11	7.1
2	Nuk kam interes	75	48.1
3	Nuk mbështes asnjë	33	21.2
4	Nuk më përfqëson asnjë	21	13.5
5	Tjetër	16	10.3
Total		156	100.0

Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Nga ana tjetër, 49% e tyre nëse zgjedhjet do të zhvilloheshin nesër, do të parapëlqenin të votonin për parti apo lëvizje të re

politike (Tabela 8). Parapëlqimi për parti apo lëvizje të re politike është një dëshirë për t'u shkëputur nga partitë tradicionale politike, por rezultatet e deritanishme të votimeve të përgjithshme kanë dëshmuar se lëvizjet e reja që kanë konkuruar në zgjedhjet e fundit parlamentare si Grupimi 99, Aleanca Kuq e Zi, Nisma, Libra nuk u mbështetën falë këtij perceptimi.

Tabela 8. Nëse do të votonit nesër, a do të preferonit të votonit për?

Nr	Preferenca për votim	Numër	Përqindje
1	Një nga 3-4 partitë kryesore	479	47.2
2	Për një parti apo lëvizje të re politike	497	49.0
3	Tjetër	39	3.8
Total		1015	100.0

Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Në këtë kuadër vërejmë se prirja për të votuar parti apo lëvizje të reja politike mbështetet më tej kur 67.2% e personave të intervistuar pohojnë se do të votonin për politikanë të rinj që sapo kanë hyrë në jetën politike të vendit (Tabela 9). Qarkullimi i elitave politike është një sfidë që ndeshet në Shqipëri dhe këto shifra tregojnë se votuesit të paktën i besojnë bindjes së tyre të brendshme për të votuar liderë të rinj.


Tabela 9. Nëse do të përzgjidhnit, a do të preferonit të kishit si drejtues të vendit...

Nr	Preferenca për votim	Numër	Përqindje
1	Politikanë që kanë qënë në politikë për 20 e më shumë vite	306	30.1
2	Politikanë të rinj që kanë hyrë rishtas	683	67.2
3	Tjetër	27	2.7
Total		1016	100.0

Burimi: CESS, anketa me qytetarët për lëvizjet sociale

Por kur janë pyetur nëse lëvizjet sociale si Nisma Thurje, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, EcoAlbania, Organizata Politike, Alternativa, Vetëvendosja do të merrnin pjesë si parti politike në zgjedhjet e ardhshme parlamentare vetëm 6.2% e personave të intervistuar do të votonin këto lëvizje, çka dëshmon se fuqia dhe

potenciali i tyre politik për t'u shndërruar në parti elektorale është i dobët. Ndërkohë që 74% e tyre kanë pohuar se do të votonin partitë e sotme tradicionale që shtrihen nga e majta në të djathtë të spektrit politik shqiptar. Përballë këtij paradoksi, mes dëshirës për të votuar lëvizje të reja politike dhe sjelljes elektorale, ku mbështetja është sërish për partitë tradicionale, vërehet se elektorati shqiptar nuk ka ende guxim të provojë përmes votës alternative të reja politike. Dualizmi mes perceptimit dhe realitetit elektorale mes votuesve në Shqipëri, është shpjegimi kryesor përse prej shumë vitesh, megjithëse shumica e njerëzve kanë perceptim negativ për partitë tradicionale, sjellja elektorale ka mbetur e pandryshuar dhe 'dualizmi politik' mes dy partive kryesore vazhdon të jetë mbizotërues, si pasojë e kësaj sjellje elektorale të pandryshueshme.



**5. PROFILE TË LËVIZJEVE AKTUALE SOCIALE
(QYTETARE) NË SHQIPËRI**

5.1 NISMA THURJE

Emri i Lëvizjes	Nisma Thurje
Logo	
Drejtuksi	Endri Shabani, Pano Sako
Viti i Themelimit	2013
Anëtarësia	E papërcaktuar
Shtrirja Gjeografike	Tiranë

OBJEKTIVAT

Lëvizja Nisma Thurje është një iniciativë e cila ka në themel të veprimtarisë së saj angazhimin e qytetarëve përballë asaj që kjo lëvizje e përcakton si "një klasë politike të organizuar" duke ftuar qytetarët të bashkohen nën moton *'Bashkohu kundër sistemit'*. Në bazë të ashtuquajturës Karta 2020, Nisma Thurje nëpërmjet aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe angazhimit social të qytetarëve, synon të përbushë një sërë objektivash të tilla si shtetëzimi i pasurisë natyrore, rishpërndarja e pasurisë dhe rigjallërimi i ekonomisë, fuqizimi i popullit dhe ushtrimi i sovranitetit në mënyrë të drejtpërdrejtë, decentralizimi i pushtetit dhe fuqizimi i mekanizmave të balancës dhe kontrollit kushtetues, demokratizimi i partive politike, garantimi i zgjedhjeve të lira e të ndershme, rikthimi në traditën e jurisë në sistemin gjyqësor, bashkimi i shqiptarëve.

AKTIVITETET

Një nga nismat e saj më të rëndësishme ku u përqëndrua ndërgjegjësimi publik lidhet me ndryshimin e sistemit aktual zgjedhor për të nxitur votimin me lista të hapura të kandidatëve për deputetë në një sistem proporcional rajonal me synimin e zgjedhjes së drejtpërdrejtë nga populli të deputetëve. Për këtë qëllim më 4 Prill 2019 Nisma Thurje ndërmori iniciativën për nënshkrimin e një peticionin publik "1 milion kundër sistemit", për të kërkuar ndryshimin e Kodit Zgjedhor nga sistem proporcional rajonal në proporcional kombëtar me lista të hapura. Nëpërmjet saj Nisma u bëri thirrje qytetarëve t'i bashkohen peticionit me qëllimin për t'u bërë bashkë 1 milion shqiptarë në mbështetje të propozimit, duke firmosur ose online ose në letër kudo nëpër Shqipëri. Më 17 Janar 2020 ish-deputeti i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ralf Gjoni, depozitoi në Kuvend një projektligj dhe relacionin shoqërues të hartuar nga Nisma Thurje ku projektligji mbështetet edhe në 50 mijë firmat e qytetarëve shqiptarë që kanë firmosur këtë peticion, të cilët kërkojnë ndryshimin e sistemit zgjedhor në Shqipëri, por që nuk arriti të miratohet nga ana e Parlamentit Shqiptar. Tashmë Nisma Thurje synon të shtrijë aktivitetet e saj në kuadër të një force politike që kërkon të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit 2021.

Lëvizja Nisma Thurje, gjithashtu, ka hedhur hapat për krijimin e një partie të re. Në shtator 2020 nisën diskutimet përmes rrjeteve sociale për mënyrën sesi duhet të qeveriset vendi dhe për këtë arsye, ftoi publikisht qytetarët t'ë japin idetë e tyre për organizimin e ri politik duke theksuar se *"Përgjatë Shtatorit do të jemi në të gjithë vendin për të krijuar një kuvendim të madh mbi idetë e reja për mënyrën se si duhet*

të qeveriset vendi dhe organizimit të ri politik. Nëse do të jesh pjesë, na shkruaj në Instagram apo regjistrohu te nismathurje.al. Koha për të bërë më shumë!” Gjatë lëvizjes së Nismës Thurje për të ndryshuar sistemin aktual zgjedhor, kësaj lëvizje iu bashkuan deputetët e parlamentit shqiptar z. Ralf Gjoni dhe ish-deputetja e Partisë Demokratike zj. Rudina Hajdari, e cila besoj se mund të kandidonte nën siglën e Nismës Thurje nëse do të paraqitej si subjekt elektorale në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare që do të zhvillohen më 25 Prill 2021. Por përfaqësuesit e Nisma Thurje kanë deklaruar se deputetja Rudina Hajdari u largua nga ata pas pamundësisë nga ana e saj për të bërë të mundur hapjen 100 për qind të listave për deputetë në ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, amendime të cilat u miratuan me 97 vota në Kuvendin e Shqipërisë.² Ndërkohë deputetja Rudina Hajdari ka deklaruar se ajo do të kandidojë në zgjedhjet e ardhshme nën siglën e një partie të re të quajtur Nisma, megjithëse emërtimi është në dukje një përkim rastësor me emrin e lëvizjes Nisma Thurje.³

Orientimi politik

Liberale

Financime

Website, Facebook, Twitter

<https://nismathurje.al>

<https://www.facebook.com/thurje/>

<https://www.instagram.com/nismathurje/?hl=en>

<https://twitter.com/nismathurje?lang=en>

“Në atë kohë mënyra se si i perceptonim realitetin dhe gjithcka tjetër ishte fakti që në Shqipëri ka një mungesë transparence. Çdo të thotë mungesë e transparencës? Është fakti se i gjithë sistemi është i modifikuar, duke filluar që nga qeveria, prokuroria, gjëndja civile etj. Ne menduam që të hynim në lojën e transparencës dhe të bëheshim zëdhënës i asaj që ndodhte, për ta shprehur realisht atë, për tu shpjeguar njerëzve ato gjëra për të cilat ne kishim informacion. Ishim në profesione të ndryshme, ekonomistë, juristë, gazetarë, urbanistë, arkitektë, inxhinierë, mjekë dhe duke qenë në profesione të ndryshme kjo na jepte mundësinë që të hynim në sa më shumë fusha dhe të jepnim një pasqyrë e transparencës reale për çfarë ndodhte, një opinion të përpunuar, jo një opinion siç vjen nga televizioni.”

Pjesë nga intervista me përfaqësues të Lëvizjes Nisma Thurje

5.2 LËVIZJA ORGANIZATA POLITIKE

Emri i Lëvizjes	Organizata politike
Logo	
	
Drejtuessi	Dr Arlind Qorri
Viti i Themelimit	2011
Anëtarësia	E papërcaktuar
Shtrirja Gjeografike	Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Elbasan

OBJEKTIVAT

Lëvizja Politike është një lëvizje me orientim përtej qendrës së majtë, e krijuar në vitin 2011, e cila mbështetet nga studentët e intelektualë të rinj, që synon të ndërgjegjësojë të rinjtë, të rrisë forcën e reagimit të tyre si grup i rëndësishëm shoqëror dhe të luftojë kundër prirjeve të politikave neoliberalë në fushën e ekonomisë e arsimit, duke vënë theksin tek rëndësia e ndërmarrjeve publike për administrimin e pasurive natyrore dhe garantimin e arsimit të lartë përmes mbështetjes së shtetit si e drejtë dhe e mirë publike. Nën moton *Tre parti një oligarki*, kjo lëvizje synon të shfaqet si një lëvizje anti-establishment kundër partive kryesore aktuale, duke synuar të kritikojë nga e majta në të djathtë të gjitha politikat ekonomike e sociale që janë ndjekur deri tani në Shqipëri.

AKTIVITETET

Dy nga lëvizjet e saj kryesore kanë qenë të lidhura me politikën për arsimin e lartë, siç është lëvizja Universiteti në Rrezik në vitin 2012 dhe Lëvizja për Universitetin që u krijua në vitin 2014 kundër projekt-ligjit për arsimin e lartë. Lëvizja për Universitetin që u nxit nga Organizata Politike u bë e para e llojit të saj me protesta, aksione simbolike me artikuj, shkrime kritike dhe një manifest që përmblihte parimet dhe shtyllat e një Universiteti të ri, më demokratik dhe gjithëpërfshirës. Lëvizja kulmoi në vitin 2015 ku parulla ishte "Për Universitetin, Për Shoqërinë!" dhe nënkuptonte që një shoqëri e lirë dhe barazimtare do të filtronte pikësëpari nga një universitet i tillë. Asokohe Lëvizja për Universitetin arriti që të nxisë debat mbi Arsimin Publik Falas dhe rolin e universitetit e studentëve në hapësirën publike. Më 4 Dhjetor 2018 nxitu revolta studentore pasi studentët e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës organizuan në mënyrë spontane një peticion, pasi ishin njoftuar papritmas nga administrata se tanimë do t'u duhej të paguanin tarifë shtesë për çdo provim të mbartur. Revolta e tyre çuan në dorëheqjen e Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe nënshkrimit të Paktit për Universitetin nga ana e qeverisë. Një nga aktivitetet e Organizatës Politike ka qenë ndërgjegjësimi i opinionit publik lidhur me të drejtat e punëmarrësve dhe veçanërisht denoncimi publik i rasteve të shfrytëzimit të punës së të miturve, aksidentet me pasojë vdekjen në punë, kryesisht në miniera, duke e lidhur atë me shfrytëzimin pakontroll të pasurive natyrore.

Orientimi politik	I majtë
Financimet	Donacione individuale të anëtarësisë
Website, Facebook, Twitter	http://organizatapolitike.org/ https://www.facebook.com/orgpol/ https://twitter.com/orgpolitike?lang=en https://www.instagram.com/organizatapolitike/?hl=en https://teza11.org/pse-teza-11/ https://www.facebook.com/PerUniversitetin/ https://www.reporter.al/si-lindi-levizja-per-universitetin-2/ http://ikesh.org/kush-jemi/ Instituti për Kritikë dhe Emancipim Shoqëror

“Në fakt, idea dhe përparësia jonë është që të jemi nxitësit e një lëvizjeje të madhe shoqërore, diçka që u provua pak me studentët. Ajo ishte, për mendimin tim, një provë e përgjithshme e asaj që do duhej të vijë më pas, një lëvizje shoqërore që i tejkalon studentët, që shkon tek punëtorët, tek të varferit, tek klasa e mesme dhe bëhet pjesë e një kauze të madhe. Në këtë kuptim synimi dhe puna jonë është të ndërtojmë këtë lloj fronti apo lëvizje shoqërore, që e përbashkon lufta ndaj oligarkisë, lufta për demokratizim politik, lufta për demokratizim dhe emancipim shoqëror.”

Pjesë nga intervista me përfaqësues të Lëvizjes Organizata Politike

5.3 LËVIZJA ALTERNATIVA

Emri i Lëvizjes	Alternativa
Logo	
Drejtuesi	Besart Kadia
Viti i Themelimit	2019
Anëtarësia	2000
Shtrirja Gjeografike	Tiranë, Korçë, Shkodër
OBJEKTIVAT	
<p>Lëvizja Alternativa është krijuar në Nëntor të vitit 2019, nën drejtimin e pedagogut e studiuesit të ri të ekonomisë, Besart Kadia, si pjesë e Albanian Enterprise Institute, synon të bashkojë profesionistët e rinj të Shqipërisë që të kontribuojnë për të sjellë ndryshime social-politike. Synimi i tyre është të ftojnë të rinjtë shqiptarë për të sjellë energjitë e tyre me ide pro tregut, duke mos u fshehur pas partive të mëdha tradicionale, por duke krijuar alternativën e saj përmes dialogut të drejtpërdrejtë me qytetarin, nëpërmjet platformave të komunikimit publik në media apo rrjete sociale.</p>	

AKTIVITETET

Ndërgjegjësim publik përmes bisedave në median elektronike dhe rrjetet sociale lidhur me taksimin e thjeshtuar, reformat pro tregut dhe transparencën e qeverisë për shpenzimet publike

Orientimi politik	Liberale
Financimet	Donacione individuale
Website, Facebook, Twitter	https://www.facebook.com/pg/qgenerataere/posts/

"Kjo është një lëvizje sociale për të kapur ato pjesë të shoqërisë që duan të largohen, por ne u themi që arsyeja pse duhet të rrimë është që të organizohemi dhe të ndikojmë tek politikbërja në Shqipëri (...). Nuk kemi një anëtarësi të mirëfilltë, por kemi organizuar takime në Tiranë, Korçë e Fier dhe kemi konsideruar si anëtarë të lëvizjes ata 2000 mbështetës që kanë ndjekur takimet tona. Ne më tepër synojmë forumet, diskutimet me aktorët publikë, rekomandimet e mundshme. Ne themi cilat janë idetë që mund ta çojnë Shqipërinë përpara. Kjo është pak a shumë struktura sesi është menduar..."

Pjesë nga intervista me përfaqësues të Lëvizjes Alternativa

5.4 LËVIZJA EKOALBANIA

Emri i Lëvizjes

EkoAlbania

Logo



Drejtuesi

Olsi Nika

Viti i Themelimit

2014

Anëtarësia

E papërcaktuar

Shtrirja Gjeografike

Tiranë, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër

OBJEKTIVAT

EkoAlbania është një organizatë dhe lëvizje qytetare për të ndërgjegjësuar komunitetet e zonave të ndryshme, opinionin publik dhe strukturat shtetërore në nivel kombëtar dhe lokal mbi rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe biodiversitetit. Të gjitha veprimtaritë e saj realizohen nga një ekip i përkushtuar dhe i specializuar profesionistësh (biologë, teknikë të fushës së mbrojtjes së mjedisit, ekspertë të komunikimit etj.) me ndihmën e një numri bashkëpunëtorësh e vullnetarësh. EkoAlbania ka si qëllim kryesor të aktivitetit të saj ruajtjen dhe menaxhimin e mjedisit dhe ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të publikut në lidhje me këtë.

AKTIVITETET

Nën sloganin "Ti japim zë mbrojtjes së lumenjve" aktivitetet kryesore të lëvizjes EcoAlbania ka qenë mbështetja e banorëve të prekur nga projektet e hidrocentraleve, ku ka përfshirë avokatë dhe ambientalistë duke organizuar fushata ndërgjegjësimi, konferenca e padit gjyqësore, për të parandaluar ndërtimin e një sërë hidrocentralesh që kërcënojnë biodiversitetin. Sipas EcoAlbania situata e HEC-eve paraqitet alarmante në gjithë territorin e Shqipërisë, ku lumenjtë në mbarë vendin janë të rrezikuar nga mbi 700 hidrocentrale që janë planifikuar të ndërtohen në gjithë vendin, duke cenuar florën dhe faunën e pasur të tyre. Nga ana tjetër këto projekte po rrezikojnë mirëqenien e banorëve të cilët kanë lidhur jetën me burimet ujore të zonës së tyre, duke i lënë ata pa ujë dhe duke cenuar zhvillimin e turizmit dhe ekonominë lokale. EkoAlbania ka spikatur veçanërisht me fushatat e saj ndërgjegjësuese kundër ndërtimit të hidrocentraleve në rrjetin e lumenjve shqiptarë ku spikat Aleanca për Mbrojtjen e Vjosës apo Aleanca Kundër Hidrocentralit të Kalivaçit, Lëvizja Mbro Valbonën dhe ato fushata që lidhen me aspekte të veçanta të ruajtjes së biodiversitetit.

Një nga aktivitetet kryesore me ndikim të Lëvizjes EcoAlbania, e organizatave mjedisore Riverwatch dhe EuroNature, si edhe 38 qytetarëve aktivistë të fshatit Kutë të Mallakastrës, ka qenë ndalimi i ndërtimit të hidrocentralit të Poçemit përgjatë lumit të Vjosës.⁴ Kjo u bë e mundur falë një padie që ata bënë në Dhjetor 2016 në Gjykatën Administrative për të kundërshtuar vendimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë në 3 maj të vitit 2016, për ti dhënë me koncesion 35 vjeçar dy kompanive turke ndërtimin e hidrocentralit të Poçemit në Luginën e Vjosës. Sipas studimeve të qeverisë shqiptare, në lumin Vjosë janë planifikuar të ndërtohen mbi 25 hidrocentrale ku më të mëdhenjtë janë hidrocentrali i Kaludhit, Dragotit, Kalivaçit, Poçemit dhe Karbonarit.

Në kuadër të Ditës së Vjosës, gjatë një konference që u zhvillua më 13-16 qershor 2019, Lëvizja EcoAlbania shpalli nismën për ta shpallur Vjosën Park Kombëtar, duke e konsideruar atë si një ndër lumenjtë e paktë të egër në Europë me rrjedhje të lirë përgjatë gjithë shtratit të tij.⁵ Presioni dhe ndërgjegjësimi publik nga ana e lëvizjes EkoAlbania e nxiti qeverinë Shqiptare në 25 shtator 2020 të miratojë si Park Kombëtar pjesën e Vjosës së lartme duke ndaluar ndërtimin e hidrocentraleve në këtë pjesë ku përfshihej edhe diga e hidrocentralit të Kalivaçit.⁶ Ndërkohë EcoAlbania arriti të ndërgjegjësojë shkencëtarë e aktivistë të huaj të mjedisit për mbrojtjen e lumit Vjosa përmes fushatës ‘*Mbro Zembrën Blu të Europës*’.⁷

Nën frymën e kësaj fushate ndërgjegjësuere e proteste, një nga aktivitetet dhe fushatat kryesore të lëvizjes EcoAlbania, është mbështetja e lëvizjes së banorëve të katër fshatrave të Njësisë Administrative Derjan të bashkisë Mat, ku spikasin ata të fshatit Zall Gjocaj. Nën moton *Mbro Parkun Kombëtar Zall Gjocaj*, ata kanë kundërshtuar ndërtimin e hidrocentralit Burie-Lura nga firma Seka Hydropower përgjatë lumit të Selitës, në fshatin Burie, që gjëndet në verilindje të këtij parku dhe dy nga 12 liqenjtë karstikë u cënohen burimet e tyre ujore.⁸ Ai është shpallur Park Kombëtar që prej vitit 1996 dhe përfshin Malin e Dejës, duke u listuar si pjesë e kategorisë së II-të të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (International Union for Conservation of Nature). Banorët ngritën një çadër të rezistencës kolektive ndërkohë në tetor lëvizja EcoAlbania e paditi në Gjykatën e Administrative të shkallës së parë ndërtimin e këtij hidrocentrali, por gjykata vendosi vazhdimin e punimeve. Çështja tashmë është apeluar.

Orientimi politik	Ambientaliste
Financimet	BE, NAVA Foundation, Leviz Albania, GEF-UNDP
Website, Facebook, Twitter	http://www.ecoalbania.org/sq/kreu/ https://www.facebook.com/EcoAlbania.org/ https://www.instagram.com/ecoalbania/ https://twitter.com/ecoalbania?lang=en

“Lëvizja jonë ishte një nismë e pedagogëve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës së Universitetit të Tiranës dhe ekipit që punonte prej pak më shumë se 3 vjetësh, për fushatën të shpëtojme zembrën Blu të Europës, siç ishte lumi Vjosa. Kjo ka qenë nxitja, fushata pastaj ka pasur si synim mbrojtjen e lumenjve me potenciale të mëdha natyrore po të themi në të gjithë Gadishullin e Ballkanit, por lugina e Lumit Vjosa ka qenë një ndër objektivat themelore të fushatës. Pastaj ajo është shndërruar në një lëvizje, ndërsa Eco-Albania nuk është një lëvizje do të thoja se është një organizatë që nxit e mbështet lëvizje sociale në mbrojtje të mjedisit.”

Pjesë nga intervista me përfaqësues të EkoAlbania

5.5 LËVIZJA VETËVENDOSJA – QENDRA NË SHQIPËRI

Emri i Lëvizjes	Lëvizja Vetëvendosja-Qendra në Shqipëri
------------------------	---

Logo



Drejtuksi	Bojken Abazi
------------------	--------------

Viti i Themelimit	11 Prill 2019
--------------------------	---------------

Anëtarësia	2000
-------------------	------

Shtrirja Gjeografike	Tiranë, Shkodër, Vlorë, Kukës
-----------------------------	-------------------------------

OBJEKTIVAT

Lëvizja Vetëvendosja – Qendra në Shqipëri është krijuar si degë e Lëvizjes së Vetëvendosjes në Kosovë dhe synon të japë mbështetjen për ushtrimin e së drejtës demokratike për vetëvendosje të popullit shqiptar për realizimin e bashkimit të shtetit të pavarur të Kosovës me Shqipërinë, duke u bazuar në Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe parimin e vetëvendosjes së popujve të shprehur në Kreun 1 të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Një nga objektivat e saj kryesorë është rritja e vetëdijes së bashkimi kombëtar dhe integrimi i Shqipërisë, dhe më gjerë i shqiptarëve, në strukturat Euro-Atlantike (si Bashkimi Evropian dhe NATO) janë procese që duhen realizuar paralelisht dhe e plotësojnë njëri-tjetrin. Për këtë arsye veprimtaria e saj synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe aktivizmit qytetar në Republikën e Shqipërisë mbi problematikat e shqiptarëve që jetojnë në treva autoktone shqiptare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe anasjelltas.

AKTIVITETET

Gjithashtu tërësia e aktiviteteve të kësaj Lëvizje është e lidhur me ngritjen e urave të komunikimit dhe projekteve të bashkëpunimit me shoqërinë civile, sferën akademike dhe intelektuale, sindikatat dhe studentët, sportistët në Shqipëri, Kosovë e në trevat shqiptare të rajonit të Ballkanit, si dhe me bashkardhetarët që jetojnë në migrim. Nga ana tjetër zhvillon aktivitete që nxisin angazhimin aktiv qytetar për çështje që lidhen me zhvillimin e drejtë ekonomik e forcimin e identitetit kombëtar. Kështu më 26 janar 2020 Lëvizja VETËVENDOSJE në Shqipëri mbështeti protestën e Sindikates së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës para Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përpara Kryeministrisë, para zyrave të kompanisë “AlbChrome” dhe përpara Inspektoriatit të Punës.⁹ Në këtë protestë sindikatat kërkonin kontratën e re kolektive, rritje pagash, rishikim normash, pagesa të bonusit të fund-vitit, njohjen e vështirësisë dhe vjetërsisë në punë, dëmshpërblim për aksidentet në punë, ndalimin e presioneve ndaj minatorëve dhe rikthimin në punë të katër drejtuesve të sindikatës që i kishin larguar në mënyrë të jashtëligjshme. Në vijim të këtyre aktiviteteve, së fundmi aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE, Qendra në Shqipëri, kanë mbështetur naftëtarët e Uzinës së Përpunimit të Thellë të Naftës në qytetin e Ballshit, të cilët që prej datës 28 shtator 2020 po zhvillojnë një grevë urie. Lëvizja VETËVENDOSJE, Qendra në Shqipëri, ka mbështetur kërkesat e naftëtarëve duke kërkuar respektimin e dinjitetit dhe të të drejtave të mbi 700 punëtorëve të kësaj rafinerie të tilla si zbatimi


i vendimit të gjykatës së vitit 2017 për pagat e prapambetura bashkë me pagat e prapambetura në gjithë këto muaj që prej ndaljes së punës në rafineri, remonti e rivendosja në punë e rafinerisë, si dhe kontrata kolektive e punës. Nga ana tjetër më 11 tetor, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE në Shqipëri kanë mbështetur nismën e banorëve të fshatit Hormovë në bashkinë Tepelenë, për rehabilitimin e memorialit të "Masakrës së Hormovës", që përkujton masakrën ndaj 207 burrave të fshatit nga andartët grekë. Lëvizja VETËVENDOSJE në Shqipëri kërkon transparencë të organeve të qeverisjes lokale për këtë rast duke këmbëngulur se memorialë të tillë duhet të mirëmbahen e të ngrihen në të gjitha rastet, kur ato ndikojnë për të kujtuar historinë dhe fuqizuar identitetin kombëtar.

Orientimi politik	E majtë
Financimet	Donacionet e anëtarësisë
Website, Facebook, Twitter	https://shqiperi.vevetendosje.org/ https://www.facebook.com/LVVShqiperi/ https://twitter.com/LVVShqiperi https://www.instagram.com/lvvsqiperi/?hl=en

"Për ne ka rëndësi veçanërisht ndërthurja e çështjes kombëtare dhe idea e shtetit të zhvilluar që lufton padrejtësitë dhe pabarazitë, në ekonomi dhe shoqëri. Mendoj që këto dy teza janë të rëndësishme për kombin shqiptar në shekullin e XIX... Nuk jemi ne që i kemi shpikur... Sigurisht çfarë nuk ka ndodhur që prej asaj kohe duhet përshtatur me nevojat e shekullit të XXI, por mund të ndiqen disa linja programore, se ne nuk e shohim veten si 'diçka e re', por ne mendojmë që jemi një vazhdimësi e përpjekjes historike të shqiptarëve, qoftë brenda Shqipërisë administrative apo edhe Kosovës, Maqedonisë e me rradhë, për të zhvilluar e bashkuar kombin shqiptar. Frymëzohemi prej Rilindjes Kombëtare edhe përpiqemi të marrim më të mirën e asaj përpjekjeje, për ta çuar përpara në kushtet e reja, në të cilat jetojnë shqiptarët."

Pjesë nga intervista me përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosja

5.6 ALEANCA PËR MBROJTJEN E TEATRIT

Emri i Lëvizjes	Lëvizja Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit
Logo	
Drejtuksi	Robert Budina, Neritan Licaj
Viti i Themelimit	2018
Anëtarësia	E Papërcaktuar
Shtrirja Gjeografike	Tiranë, Durrës
OBJEKTIVAT	
<p>Aleanca Për Mbrojtjen e Teatrit u themelua në 18 prill 2018 dhe është një lëvizje qytetare, si reagim ndaj vendimit të qeverisë shqiptare për të shembur godinën e Teatrit Kombëtar, godinë e vitit 1938 dhe për të ndërtuar aty, përmes partneritetit publik privat (PPP) një godinë të re teatri kombëtar në bazë të projektit të arkitektit danez Bjorn Ingels.¹⁰ Vendimi u bë shkas që në Lëvizjen "Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit", nën moton 'Mburo Teatrin – Teatri Kombëtar Monument Kulture – Mbrohet nga populli' të përfshiheshin qytetarë, aktorë, urbanistë, arkitektë, aktivistë të shoqërisë civile, të cilët u ngujuan në godinën e Teatrit Kombëtar dhe protestuan në forma të ndryshme për më shumë se dy vjet, që Teatri Kombëtar të mos shembej, por të ristrukturohej duke patur parasysh rëndësinë e tij si godinë me vlera historike.</p>	
AKTIVITETET	
<p>Edhe Forumi "Europa Nostra", falë fushatave të ndërgjegjësimit të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, e renditi atë ndër 7 ndërtesat më të rrezikuara në Europë që duhej ruajtur për "simbolikën e saj për kulturën kombëtare dhe për gjithë Europën, me historinë e saj 80-vjeçare".¹¹ Pasi godina e Teatrit Kombëtar u shemb nga Bashkia Tiranë më 17 maj 2020, pas vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës,¹² Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit nisi nënshkrimin e peticionit 'Për Rindërtimin e Teatrit' duke mbledhur firma në të gjithë Shqipërinë, duke ftuar qytetarët që të nënshkruajnë për rindërtimin e teatrit të shembur në të njëjtin vend dhe me modelin arkitekturor ekzistues. Për shkak të aktivitetit të tyre të gjatë, pranisë së përfaqësuesve së saj publikë në median e shkruar dhe elektronike dhe reagimit pas shembjes së TK më datë 17 maj 2020, roli dhe pesha e kësaj lëvizje në opinionin publik ka qenë më e madhe sesa lëvizjet e tjera sociale</p>	
Orientimi politik	E papërcaktuar
Financimet	
Website, Facebook, Twitter	https://www.facebook.com/pg/Aleanca-p%C3%ABr-Mbrojtjen-e-Teatrit-zyrtare-110243613751205/posts/ https://twitter.com/perteatrin

“Nëpërmjet kësaj lëvizje ne sollëm një ndikim tek publiku, e ndërgjegjësuam atë duke dalë në shesh, duke u përplasur me forcat e rendit për të ruajtur një pasuri publike dhe historike që lidhej me kujtesën kulturore të qytetit e më gjerë.... Nuk kishte ndodhur për gati 100 vjet që përmes mosbindjes civile një grup qytetarësh, artistësh, aktivistësh me profesione të ndryshme, të futeshin brenda një godine, si TK, jo vetëm për ta ruajtur por për ti bërë thirrje vetëdijes e ndërgjegjes publike e qytetare që ai duhej të restaurohej. (...) Pavarishtë se nuk ia dolëm ta shpëtonim, lëvizja jonë për mbrojtjen e Teatrit i bëri qytetarët më të vetëdijëshëm se duhet të angazhohen të gjithë (...) Problemi është tek rrënjët e vetëdijes qytetare, sa të forta janë ato (...) ndryshe Teatri nuk do të shembej.”

Pjesë nga intervista me përfaqësues të Lëvizjes Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar

6. KONKLUZIONE

Shqipëria nuk ka një traditë të gjerë të lëvizjeve sociale (qytetare). Kjo traditë i ka fillesat në fillim të viteve 1990-të, me një reagim të fortë civil ndaj sistemit totalitar. Ndonëse e shtrirë në vetëm tri dekada, historia e saj është pasuruar gjithmonë e në rritje me subjekte të reja sociale dhe kauza të reja, që përbëjnë shqetësim dhe interes për shoqërinë shqiptare.

Qeveritë vazhdimisht prodhojnë probleme arbitrare; ndaj është dhe do të jetë i nevojshëm reagimi kundër këtyre problemeve si dhe rritja e këtij reagimi. Është e rëndësishme që të dimë se si të vlerësojmë më shumë dhe më mirë misionin, vlerat, rolin dhe kontributet e lëvizjeve sociale (qytetare). Së pari, shoqëria pritet të jetë më pjesëmarrëse, më e pranishme dhe më aktive në kauza relevante.

Më tej, një mbështetje publike aktive nga prezenca e organizmave ndërkombëtare në Shqipëri, të tilla si organizatat shumëpalëshe, trupi diplomatik i akredituar në Shqipëri, etj., do të kishte një kontribut shumë pozitiv për rritjen e prestigjit të këtyre lëvizjeve të opinionit publik dhe në median masive.

Të dhënat e anketës për aktivitetin dhe ndikimin e lëvizjeve sociale (qytetare) që veprojnë në Shqipëri na japin një vështrim të përgjithshëm të mënyrës se si perceptohet aktiviteti dhe reagimi i tyre, kapaciteti dhe ndikimi në mbrojtjen e interesit publik. Në përgjithësi, njohuria e kufizuar e të anketuarve mbi këto lëvizje lidhet me faktin se aktivitetet janë të përqendruara kryesisht në Tiranë dhe nuk karakterizohen nga përpjekje për të mobilizuar masa të një shkalle të gjerë.

Përveç Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, e cila ka pasur një pasqyrim më të gjerë në media, për shkak të përqendrimit të veprimtarisë në Tiranë, si rrjedhojë e vendndodhjes së teatrit dhe pasqyrimin në media për shembjen e ndërtesës së Teatrit Kombëtar më 17 maj 2020, lëvizje të tjera sociale si Nisma Thurja, EcoAlbania, Alternativa duket të kenë një nivel më të ulët njohjeje nga publiku. Mungesa e burimeve financiare është një arsye kryesore që kushëtzon veprimtarinë e tyre. Burime të kufizuara dhe të pamjaftueshme financiare i pengojnë që të organizojnë aktivitete intensive ndërgjegjësuere apo që të arrijnë në zona të tjera përtej kryeqytetit.

Nisma Thurje, Organizata Politike dhe Vetëvendosje - Shqipëri janë lëvizje qytetare që kanë potencialin të shndërrohen në parti politike. Qëllimet dhe objektivat që ato kanë përcaktuar lidhen me aspekte që u përkasin partive si subjekte zgjedhore.

Për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, Nisma Thurje, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit dhe EcoAlbania kanë përdorur peticione dhe padi në gjykatat për kauzat që ata mbrojnë, si një mjet për të tërhequr vëmendjen e medias si dhe ndikimin e tyre në shoqëri, me synim përfshirjen e një

numri më të madh qytetarësh në mbështetje të ndryshimeve në fusha të tilla si sistemet zgjedhore, mbrojtja e trashëgimisë historike dhe kulturore, dhe biodiversiteti. Pavarësisht nga indiferenca për të marrë pjesë në këto lëvizje, qytetarët kanë shprehur dëshirën për një rol dhe veprim më të fortë të këtyre lëvizjeve në jetën publike.

Përdorimi i medias së shtypur dhe asaj elektronike apo e medias sociale si Facebook-u kanë qenë kanalet kryesore që kanë përdorur këto lëvizje për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, ndonëse protestat apo fushatat ndërgjegjësuese kërkojnë pjesëmarrje masive të qytetarëve.

Sigurisht që një mospjesëmarrje e gjerë qytetare në veprimtari të ndryshme shpjegohet edhe me kulturën e pamjaftueshme të qytetarëve të sotëm shqiptarë për të reaguar ndaj akteve arbitrare të qeverisë që prekin interesat e shoqërisë. Për këtë arsye, shpesh këto lëvizje konsiderohen si "palestra të demokracisë" dhe prania e tyre në jetën publike u lejon qytetarëve, të rinjve, dhe grupeve të interesit të përipiqen dhe të forcojnë aftësitë e tyre për të mbrojtur interesa publike të caktuara, përtej nivelit tradicional të përfaqësimit të interesave nga partitë politike.

Lëvizjet sociale (qytetare) janë një pasuri e pazëvendësueshme e një shoqërie, me një objektivi të gjerë dhe rol dhe ndikim domethënës për të mirën e përparimit të vendit.

Pavarësisht nga gatishmëria për të votuar fytyra të reja, zgjedhësit përsëri u kthehen partive tradicionale dhe kjo lidhet edhe me kapacitetin e ulët aktual të këtyre lëvizjeve për ta profilizuar veten si aktorë politikë. Këto lëvizje kanë kapacitetin për mobilizim rreth çështjeve specifike në një kontekst të caktuar, por nuk kanë struktura dhe kapacitete për mobilizim si aktorë politikë rreth zgjedhjeve.

Pjesa më e madhe e lëvizjeve nuk kanë anëtarësi të qartë dhe të identifikuar, dhe as nuk është e qartë se cila është gjendja e financave të tyre. Gjithashtu, gatishmëria për t'u bërë aktorë politikë nuk mund të vlerësohet. Peizazhi i këtyre lëvizjeve është shumë fluid duke treguar mungesën e një procesi të mirëmbledhur para krijimit të tyre. Një shembull është lëvizja "Alternativa" e cila supozohej të ishte një lëvizje e rreshtuar në krahun e djathtë, por që drejtuesi i së cilës sapo u dekretua së fundmi si zëvendësministër i financave, duke e shuar ekzistencën e kësaj lëvizjeje nëpërmjet dukurisë së emërimit (njohur si kooptimi).

Historia e lëvizjeve në të shkuarën tregon se kur ato janë shndërruar në subjekte zgjedhore, e humbasin relevancën dhe nuk kanë qenë në gjendje të mobilizojnë mbështetje të mjaftueshme për të patur të zgjedhur në parlament (shembuj si Lëvizja Mjaft - G99, partia Sfida, Partia LIBRA, Aleanca Kuq e Zi, etj.). Shumë prej lëvizjeve të reja paragjykohe dhe keqgjykohen deri në atë pikë sa edhe mbështetja e donatorëve kundrejt tyre ka qenë thujtë jo-ekzistente. Në këtë kuadër, donatorët duhet të jenë më të qëllimshëm në mbështetje të lëvizjeve të reja në mënyrë që të rriten opsionet politike në vend dhe të rritet trysnia nga aktorë të rinj për demokratizimin e mëtejshëm të sistemit politik (shembulli i Nisma Thurje në mbrojtje të listave të hapura për zgjedhjet e radhës). Lëvizjet që bazohen në tema duket se janë më të sukseshme në tërheqjen e qytetarëve.

Sa i takon marrëdhënies me median duket se media tradicionale nuk krijon hapësirë të mjaftueshme për pasqyrimin e qëndrimeve dhe veprimeve të lëvizjeve. Ndërkohë, përgjumja e përgjithshme qytetare në vend mund të shpjegohet me anë të 1) veprimeve të qeverisë për të diskretizuar çdo lëvizje qytetare dhe drejtues dhe përpjekjeve për të kornizuar çdo zë kundërshtues si pjesë të agjendës së opozitës, dhe 2) kulturës së pamjaftueshme të qytetarëve për të reaguar ndaj veprimeve arbitrare të qeverisë që prekin interesat e shoqërisë.

Nga ana tjetër, dualizmi midis perceptimit dhe realiteti zgjedhor të votuesit në Shqipëri është shpjegimi kryesor se pse për shumë vjet, ndonëse pjesa më e madhe njerëzve kanë një perceptim negativ për partitë tradicionale, sjellja zgjedhore ka mbetur e pandryshuar dhe 'dualizmi politik' midis dy partive kryesore vijon të jetë mbizotërues.

BIBLIOGRAFIA

Bieber, Florian; Brentin, Dario (2018, ed) Social Movements in the Balkans. Rebellion and Protest from Maribor to Taksim, Centre for Southeast European Studies (CSES), University of Graz, Austria

Bordignon, Fabio; Ceccarini, Luigi (26 March 2014). "Protest and project, leader and party: normalisation of the Five Star Movement". *Contemporary Italian Politics*. 6 (1): 54- 72.

Bosi, L. and Uba, K. (2009) Introduction: The Outcomes of Social Movements. *Mobilization: An International Journal* 14 (4): 409–415.

Buechler, Steven M (1995). *New Social Movement Theories*, Sociological Quarterly Volume 36 Issue 3, Pages 441 - 464, 1995.

Daniels, R. V. (2000) The Anti-Communist Revolutions in the Soviet Union and Eastern Europe 1989-1991. In D. Parker (Ed.) *Revolutions and the Revolutionary Tradition in the west 1560-1991*. London: Routledge, pp. 202-24.

Della Porta, D. and Diani, M. (1999) *Social Movements: An Introduction* Oxford: Blackwell; Diani, Mario (1992). "The concept of social movement". *The Sociological Review*. 40 (1): 1–25. ISSN 0038-0261

Dolata, Ulrich; Schrape, Jan-Felix (2016). "Masses, Crowds, Communities, Movements: Collective Action in the Internet Age". *Social Movement Studies*. 15 (1): 1–18

Donatella della Porta; Hara Kouki; Joseba Fernandez (2017). "Left's Love and Hate for Europe: Syriza, Podemos and Critical Visions of Europe During the Crisis". In Manuela Caiani; Simona Guerra (eds.). *Euroscepticism, Democracy and the Media: Communicating Europe, Contesting Europe*. Palgrave Macmillan UK. p. 236. ISBN 978-1-137-59643-7

Eminagic, Emin (2017) *Towards a De-Ethnicized Politics: Protests and Plenums in Bosnia and Herzegovina* in Jasmin Mujanović (ed.), 2017, *The Democratic Potential of Emerging Social Movements in Southeastern Europe*, 68 pages (page 23-27)

Haines, Herbert H. (1995). *Black Radicals and the Civil Rights Mainstream, 1954–1970*. Univ. of Tennessee Press. pp. 98–118. ISBN 978-1-57233-260-7

Kitschelt, H. (1986) Political Opportunity Structures and Political Protest: Anti-Nuclear Movements in Four Democracies. *British Journal of Political Science*, 16(19): 57–85. DOI: <http://dx.doi.org/10.1017/S000712340000380X>

Knezic, Marko (2017) *Social Movements and Democratization in Serbia since Milošević* in Jasmin Mujanović (ed.), 2017, *The Democratic*

Potential of Emerging Social Movements in Southeastern Europe, 68 pages (pp 23-27)

Kolb, F. (2004) The Impact of Transnational Protest on Social Movement Organizations: Mass Media and the making of ATTAC Germany. In della Porta, D. and Tarrow S. (eds.) Transnational protest and global activism

James, Paul; van Seeters, Paul (2014). Globalization and Politics, Vol. 2: Global Social Movements and Global Civil Society. London: Sage Publications.

McCarthy, John; Zald, Mayer N. (May 1977). "Resource Mobilization and Social Movements: a Partial Theory". *American Journal of Sociology*. 82 (6): 1212–1241

Miller, David L (2000) Introduction to Collective Behavior and Collective Action, Prospect Heights, IL: Waveland Press, 2000 2d edition.

Mujanović, Jasmin (ed.), 2017, The Democratic Potential of Emerging Social Movements in Southeastern Europe, 68 pages

Piven, Francis; Cloward, Richard (Summer 1991). "Collective Protest: A Critique of Resource Mobilization Theory". *International Journal of Politics, Culture, and Society*. 4 (4): 435–458

Scott, John; Marshall, Gordon (2009), "Social movements", A Dictionary of Sociology, Oxford University Press, ISBN 978-0-19-953300-8

Smelser, Neil J (1962). Theory of Collective Behavior, Free Press, Glencoe, Ill., 1962

Stoiciu, Victoria (2017) Romania's Years of Turmoil, 2012–2015 in Jasmin Mujanović (ed.), 2017, The Democratic Potential of Emerging Social Movements in Southeastern Europe, 68 pages (page 7-11)

Suzanne Staggenborg (2008), Social Movements, Oxford University Press., ISBN 978-0-19-542309-9

Tarrow, Sidney (1994) Power in Movement: Collective Action, Social Movements and Politics, Cambridge University Press, . ISBN 0-521-42271-X

Tilly, Charles. (1978) From Mobilization to Revolution. Reading, Massachusetts: Addison-Wesley.

Tsoneva, Jana (2017) Vectors of Ex / Inclusion in Bulgarian Civil Society Post-2013 in Jasmin Mujanović (ed.), 2017, The Democratic Potential of Emerging Social Movements in Southeastern Europe, 68 pages (page 11-17)

Wolfgang Rudig (1990). Anti-nuclear Movements: A World Survey of Opposition to Nuclear Energy, Longman

Buechler, Steven M (1995). New Social Movement Theories, Sociological Quarterly Volume 36 Issue 3, Pages 441 - 464, 1995.

1 <https://hashtag.al/index.php/2020/09/03/nisma-thurje-krijon-parti-te-re/>

(SHENIME)

1 <https://hashtag.al/index.php/2020/09/03/nisma-thurje-krijon-parti-te-re/>

2 <https://www.monitor.al/fitojne-banoret-gjykata-administrative-ndalon-punimet-per-hidrocentralin-e-pocemit-ne-vjose/>

3 <http://www.ecoalbania.org/sq/event/dita-e-vjoses-vizioni-per-park-kombetar/>; <https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/05/Angazhimi-i-Komunitetit-%E2%80%93-Tregues-i-Integritit-n%C3%AB-Vendim-marrje-AKTIV.pdf>; https://www.youtube.com/results?search_query=top+story+vjosa (Top Story-'Liqenet mbi Vjosë-Dy hidrocentrale po zhdukin lumin më të egër në Europë

4 <http://www.ecoalbania.org/sq/2020/09/25/kryeministri-rama-reagon-kalivac-nuk-do-te-ndertohet/>

5 <http://www.ecoalbania.org/sq/tag/te-shpetojme-zemren-blu-te-evropes/page/21/>

6 <https://portavendore.al/2020/01/23/banoret-e-kater-fshatrave-ne-lufte-per-mbrojtjen-e-parkut-kombetar-zallgjocaj/>
<https://www.facebook.com/pg/zallgjocaj/posts/>
<https://www.facebook.com/EcoAlbania.org/posts/2543090629105167/>

7 <https://argumentum.al/lajmi/2020/01/levizja-vetevendosje-ne-shqiperi-proteste-ne-mbeshkje-te-minatoreve-minatoret-e-bulqizes-nuk-jane-vetem/>

8 <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20180926123505ligji%20nr.%2037,%20dt.%2020.9.2018%20i%20rishikuar,%20i%20rivotuar.pdf>
Ligj Nr 37/2018 Për përcaktimin e procedurës së vecantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i Projektit Urban dhe Godinës së re të Teatrit Kombëtar

9 <http://7mostendangered.eu/sites/national-theatre-of-albania-tirana-albania/>

10 <https://exit.al/wp-content/uploads/2020/05/vkb-50.pdf> Vendimi Nr 50 datë 14.05.2020 i Këshillit Bashkiak – Tiranë Për miratimin e shëmbjes së godinës së Teatrit Kombëtar, pasuri në pronësi të Bashkisë Tiranë, bazuar në Akt-Ekspertizën e hartuar nga Instituti Kombëtar i Ndërtimit 'Mbi vlerësimin e godinës së Teatrit Kombëtar'.

**Western Balkans
Democracy Initiative**



**Funded by
UK Government**

**Westminster Foundation for
Democracy (WFD)**

www.wfd.org/wbdi

